



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

KORNIZË PËR PËRFSHIRJEN E NXËNËSEVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE NË SHKOLLAT E MESME TË LARTA



**KORNIZË PËR PËRFSHIRJEN
E NXËNËSVE ME NEVOJA
TË VEÇANTA ARSIMORE
NË SHKOLLAT E MESME TË LARTA**

Ky dokument është hartuar dhe publikuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës,
në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës
“Ndërtimi i kapacitetit për arsim gjithëpërfshirës – INCLUDE”.
Opinionet e shprehura këtu nuk mund në asnjë mënyrë të merren si pasqyrim i opinionit të asnjëres palë.

Funded
the European Union
e Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe

Fjala e Ministres

Të dashura nxënëse dhe të dashur nxënës,

Të nderuar mësimdhënës, mësimdhënëse dhe prindër,

Kam kënaqësinë që në emër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, të sjellë në duart tuaja Kornizën për përfshirjen e nxënëseve dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e mesme të larta. Ky dokument është rezultat i punës së përkushtuar të ekspertëve vendorë e ndërkombëtarë të arsimit dhe ka për qëllim rritjen e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në arsimin e mesëm të lartë. Korniza ka rol qenësor në ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta, sepse krijon mundësi që shkollat e mesme të larta të jenë të përgatitura në ofrimin e qasjes dhe arsimit cilësor për të gjithë nxënësit.



Korniza për përfshirjen e nxënëseve dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e mesme të larta siguron informacion mbi gjendjen aktuale të nxënësve të kësaj grup moshë, legjislacionin në fuqi, përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta, përgjegjësitë e të gjithë akterëve dhe shërbimet mbështetëse që ofrohen në nivel qendror, komunal dhe shkollor. Në të njëjtën kohë, Korniza identifikon sfidat me të cilat ballafaqohen nxënëset dhe nxënësit me nevoja të veçanta në arsimin e mesëm të lartë dhe ofron modele të adresimit të tyre.

Mësimdhënëset dhe mësimdhënësit, instruktorët dhe asistentët kanë rol substancial në sigurimin e pjesëmarrjes dhe suksesit që nxënësit kanë në shkolla. Prandaj, ky dokument i ndihmon ata që të njohin dhe adresojnë nevojat shtesë dhe specifike që kanë nxënësit me nevoja të veçanta në mënyrë që ata të aftësohen për tregun e punës dhe për jetë.

Udhëzimet e ofruara në këtë dokument do të ndihmojnë nxënësit me nevojat të veçanta të përfitojnë njohuri dhe kompetenca në përputhje me mundësitë dhe potencialet e tyre për të qenë konkurrentë me bashkëmoshatarët në tregun e punës. Zbatimi me sukses i Kornizës për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e mesme të larta do të mundësojë përfshirje më të mirë, pjesëmarrje më aktive dhe zhvillim më dinamik të potencialit të këtyre nxënësve.

Unë ftoj të gjithë akterët e kësaj fushe në arsim që të punojnë së bashku në jetësimin e këtij dokumenti në praktikë, sepse vetëm duke bashkëpunuar e bashkërenduar mund të arrijnë të adresojnë dhe eliminojnë barrierat e këtij rrugëtimi për nxënësit me nevoja të veçanta. Ju siguroj se do të keni mbështetjen dhe përkushtimin tim dhe të të gjithë kolegeve dhe kolegëve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në zbatimin e suksesshëm të kornizës dhe dokumenteve të tjera pasuese që ndihmojnë gjithëpërfshirjen në arsim.

Sinqerisht,

Arberie Nagavci,
Ministre

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtesat	7
1. Hyrje	9
2. Përkufizimet e koncepteve kryesore	10
3. Gjithëpërfshirja në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë - korniza ligjore	11
4. Sfidat në shkollat e mesme të larta në plotësimin e nevojave të nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara	12
5. Sistemet e mbështetjes për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta rregullta në Kosovë	14
5.1. Mbështesin nivelin nacional	14
5.1.1. Qendrat Burimore	15
5.2. Mbështetje për shkollat e mesme të larta në nivelin komunal	16
5.2.1. Zyrtarët e arsimit gjithëpërfshirës	16
5.3. Mbështetje në nivel shkolle	18
5.3.1. Mësimdhënës ndihmës	18
5.3.2. Psikolog shkolle	19
5.3.3. Këshilltar karriere dhe udhëzues	19
5.3.4. Asistentë për nxënës me NVA	20
5.3.5. Ekipi mbështetës	20
5.3.6. Mbështetje gjatë punës praktike në AAP	21
5.3.7. Plan individual arsimor (PIA)	21
5.3.7. Madhësia e klasës	22
6. Udhëzime për shkollat dhe mësimdhënësit se si të përfshijnë dhe mbështesin nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta rregullta në Kosovë	23
6.1. Përgatitjet në shkollë	23
6.2. Identifikimi i nevojave të veçanta arsimore	24
6.3. Akomodimet dhe modifikimet bazuar në nevojat individuale të një nxënësi	25
6.4. Udhëzime për mësimdhënësit për t'i plotësuar nevojat e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara	26
6.5. Këshilla praktike për mësimdhënësit në menaxhimin e një klase gjithëpërfshirëse	27
6.6. Si të mbështeten nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta rregullta	29
6.6.1. Nxënësit me aftësi të kufizuara specifike në mësimnxënie	30
6.6.2. Nxënës me paaftësi intelektuale	31
6.6.3. Nxënës me dëmtime në dëgjim	32
6.6.4. Nxënës me dëmtime në shikim dhe të verbër	33
6.6.5. Nxënës me dëmtime fizike	34
6.6.6. Nxënësit me ÇHDV dhe ÇDV	35
6.6.7. Nxënës me Çrregullim të Spektrit të Autizmit	36
6.6.8. Nxënësit me probleme emocionale	37
Referenca	38

Shkurtesat

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
BE	Bashkimi Evropian
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
ÇMV	Çrregullimi i Mungesës së Vëmendjes
ÇMVH	Çrregullim i Mungesës së Vëmendjes dhe Hiperaktiviteti
ÇSA	Çrregullimi i Spektrit të Autizmit
DAAP	Divizioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional
GP	Grupi Punues
INCLUDE	Projekti i Përbashkët i BE/KiE Ngritja e Kapacitetit për Arsim Gjithëpërfshirës
KiE	Këshilli i Evropës
KKK	Korniza Kurrikulare e Kosovës
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
NVA	Nevojat e Veçanta Arsimore
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara =
PIA	Plani Individual i Arsimit
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
QB	Qendra Burimore
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UA	Udhëzim Administrativ

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo kornizë për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta në Kosovë është përgatitur nga Grupi Punues, i themeluar me vendim nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe nga konsulentët e Këshillit të Evropës Marja Matero and Gazmend Tahiraj me mbështetjen e projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës – Ngritja e Kapacitetit për Arsim Gjithëpërfshirës në Arsim – INCLUDE.

MASHTI në vazhdimësi ka zhvilluar politika arsimore për të avansuar sistemin arsimor gjithëpërfshirës të arsimit parauniversitar në mënyrë që nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta për qasje në arsim dhe t'a vijojnë mësimin si dhe të marrin pjesë në shkollat e rregullta.

Praktikat gjithëpërfshirëse deri më tani janë fokusuar kryesisht në arsimin paraillor, fillor dhe atë të mesëm të ulët. Është e rëndësishme që pas përfundimit të arsimit të mesëm të ulët, nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara të vazhdojnë arsimimin e tyre në shkollën e mesme të lartë dhe të mbështeten në shkollë dhe mësim. Kjo kornizë fokusohet në fuqizimin e shkollave të mesme të larta që të jenë më të përgatitura për të siguruar qasje dhe arsim cilësor për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara.

Korniza ofron informacione mbi argumentet ligjore për përfshirjen e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara, si dhe sfidat në shkollat e mesme të larta për të pranuar nxënës me NVA dhe aftësi të kufizuara. Poashtu, korniza ofron informacione mbi shërbimet mbështetëse në nivelin qendror, komunal dhe shkollor, si dhe paraqet përgjegjësitë e akterëve të ndryshëm që punojnë për ofrimin e shërbimeve mbështetëse.

Mësimdhënësit luajnë rol të rëndësishëm në sigurimin e pjesëmarrjes dhe suksesit në shkollim për të gjithë nxënësit. Nxënësit me NVA dhe me aftësi të kufizuara kanë nevojat e tyre arsimore shtesë dhe mësimdhënësit në shkollat e rregullta duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë. Është thelbësore që mësimdhënësit të trajnohen dhe të mbështeten për të bërë përshtatjet e nevojshme të mësimdhënies dhe për të modifikuar kurrikulën kur është e nevojshme për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara. Ky udhëzim ofron informacion mbi arsimimin me nevoja të veçanta dhe aftësi të kufizuara, dhe i orienton shkollat dhe mësimdhënësit se si t'i përkrahin nxënësit me NVA në shkollat e rregullta.

1. Hyrje

Sipas legjislacionit në fuqi, në Kosovë shkollat dhe institucionet e tjera të trajnimit duhet të respektojnë parimin e arsimit gjithëpërfshirës duke akomoduar të gjithë fëmijët pa dallim nga kushtet e tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore ose të tjera dhe të ofrojnë mbështetje adekuate bazuar në nevojat individuale të nxënësve.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka zhvilluar praktika gjithëpërfshirëse dhe shërbime mbështetëse për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara. Këto praktika kanë gjetur zbatim kryesisht tek nxënësit në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët. Nuk ka të dhëna se çfarë ndodh me nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara pas përfundimit të arsimit të mesëm të ulët. Disa prej tyre vazhdojnë mësimet në profile profesionale në QB, disa nuk vazhdojnë shkollimin tutje dhe disa zgjedhin drejtimin e përgjithshëm të arsimit të mesëm të lartë.

Për të sqaruar situatën, MASHTI në bashkëpunim me projektin INCLUDE ka kryer një "vlerësim të nevojave të veçanta arsimore në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë" në nëntor të vitit 2020. Rezultatet e vlerësimit treguan se shumica e drejtorëve dhe mësimdhënësve të shkollave të mesme të larta kanë qëndrime pozitive dhe gjithashtu janë të gatshëm të sigurojnë qasje për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara. Rezultatet gjithashtu treguan se shkollat përballen me sfidat e mëposhtme në përfshirjen e këtyre nxënësve:

- kushtet e shkollës (p.sh. infrastruktura) janë të dobëta dhe nuk janë të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuara,
- mësimdhënësit nuk janë të trajnuar se si t'i plotësojnë nevojat e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara,
- mësimdhënësit nuk janë të trajnuar për të bërë përshtatjen dhe modifikimin e kurrikulës për nxënësit,
- mungojnë shërbimet e mjaftueshme mbështetëse,
- mungojnë materiale dhe pajisje të përshtatura për mësim/mësimdhënie.

Kjo kornizë synon të fuqizojë shkollat për të përmbushur nevojat e veçanta dhe individuale të nxënësve përmes:

- ofrimit të informacionit në lidhje me shërbimet e mbështetjes në dispozicion në nivel qendror, komunal dhe shkolle,
- sqarimit të roleve dhe përgjegjësi të akterëve të ndryshëm në mbështetjen e nxënësit,
- ofrimit të udhëzimeve se si të mbështeten nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollë,
- ofrimit të informacionit për mësimdhënësit se si të plotësohen nevojat e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara në klasat e rregullta.

Përfutjesit përfundimtarë të kësaj kornize do të jenë nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara.

//

Qëllimi kryesor i kornizës është rritja e qasjes dhe ofrimi i arsimit cilësor për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta të rregullta. //

2. Përkufizimet e koncepteve kryesore

Nevojat e veçanta arsimore dhe aftësitë e kufizuara është një term që përshkruan vështirësitë dhe aftësitë e kufizuara që mund të ndikojnë në aftësinë për të mësuar.

Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar (Neni 39), një fëmijë ka **vështirësi në të nxënë** nëse:

- ka vështirësi dukshëm më të mëdha në mësim sesa shumica e fëmijëve të asaj moshe; ose
- ka një aftësi të kufizuar e cila e ndalon ose e pengon atë nga përdorimi i pajisjeve arsimore të llojit që ofrohen në përgjithësi për fëmijët e moshës së tij në institucionet arsimore dhe aftësuese.

Aftësia e kufizuar mund të përkufizohet në mënyra të ndryshme. **Modeli mjekësor** përshkruan aftësinë e kufizuar si pasojë e një gjendjeje shëndetësore, sëmundje ose të shkaktuar nga lëndimi që ka ndikim të rëndësishëm dhe afatgjatë në jetën e një personi. Aftësia e kufizuar shihet si një gjendje që ka një person dhe duhet parandaluar, trajtuar ose shëruar. **Modeli social** thekson rolin e barrierave fizike, të qëndrimeve, komunikuese dhe shoqërore me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara në jetë. Këto barrierë kufizojnë aktivitetet e një personi me aftësi të kufizuara më shumë sesa vetë gjendja ose dëmtimi. **Modeli funksional** përcakton aftësinë e kufizuar si pasojë e një çrregullimi fizik, mjekësor ose njohës. Aftësia e kufizuar në vetvete kufizon funksionimin e jetës së përditshme të një personi.

Vështirësia specifike në të nxënë është një çrregullim neuro-zhvillimor i cili ndikon në të nxënë dhe përpunim të informacionit. Vështirësitë më të zakonshme specifike në të nxënë janë vështirësitë në lexim (disleksia), në shkrim (disgrafia), matematikë (diskalkulia), shkathtësi fine motorike (dispraksia) dhe në interpretimin e perceptimeve (vizuale, dëgjimore, prekëse, kinestetike). Ato ndodhin pavarësisht nga inteligjenca dhe mund të kenë ndikim të rëndësishëm në arsim dhe në të nxënë, posaçërisht nëse nuk ofrohet mbështetje për nxënësin.

Arsyet më të shpeshta për nevoja të veçanta arsimore



Dëmtime në dëgjim



Çrregullime neurologjike, p.sh. ÇMV, ÇMVH



Dëmtime në të parë



Çrregullimet në të folur dhe gjuhë



Dëmtime fizike



Probleme emocionale dhe të sjelljes



Dëmtime intelektuale



Vështirësi specifike në të nxënë



Spektri i autizmit

Përshtatjet u referohen ndryshimeve në mënyrën se si mëson një nxënës dhe përfshijnë ndryshimet e bëra në materialin mësimor, përdorimit të pajisjeve dhe procesit të mbështetjes që do t'i mundësojë një nxënësi të kryejë detyrat në mënyrë më efektive.

Modifikimet u referohen ndryshimeve në atë që pritet të mësojë një nxënës. Ndryshimet bëhen në përmbajtjen e kurrikulës dhe rezultatin përfundimtar të modulit.

3. Gjithëpërfshirja në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë - korniza ligjore

Shkollat e mesme të larta, janë të obliguara që të ofrojnë qasje dhe arsim cilësor dhe të bëjnë të gjitha përshtatjet e nevojshme për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara. Ky detyrim dhe korniza ligjore rregullohet me Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar (2011) dhe me Ligjin për Arsim dhe Aftësim Profesional Nr. 04/L-138.

Ligji për Arsim Parauniversitar përcakton arsimin gjithëpërfshirës sipas dispozitave të Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijës (1989), Deklaratës së UNESCO-s të Salamankës (1994) dhe Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2007).

Sipas Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2007), e drejta për arsimim kërkon që:

- Personat me aftësi të kufizuara të mos përjashtohen nga sistemi i arsimit të përgjithshëm në bazë të aftësisë së kufizuar dhe nga arsimi fillor falas dhe i detyrueshëm, ose nga arsimi i mesëm, në bazë të aftësisë së kufizuar;
- Personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në një arsim fillor gjithëpërfshirës, cilësor dhe falas dhe në arsimin e mesëm në mënyrë të barabartë me të tjerët në komunitetet në të cilat ata jetojnë;
- Të ofrohen përshtatje të arsyeshme ndaj kërkesave të individit;
- Personat me aftësi të kufizuara të marrin mbështetjen e duhur, brenda sistemit të arsimit të rregullt, për të lehtësuar arsimimin e tyre efektiv;
- Të sigurohen masa efektive të mbështetjes së individualizuar në mjedise që maksimizojnë zhvillimin akademik dhe shoqëror në përputhje me qëllimin e gjithëpërfshirjes së plotë.

Parimi i arsimit gjithëpërfshirës nënkupton:

- institucionet arsimore dhe aftësuese duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe kontaktin në mes të fëmijëve;
- mbështetja përkatëse duhet të ofrohet bazuar në nevojat intelektuale të nxënësve; dhe
- mjediset speciale arsimore apo shkollat speciale arsyetohen vetëm pasi që nga vlerësimi i ekspertit del se nuk është praktike të regjistrohet ndonjë fëmijë në shkollën e rregullt publike apo në institucionin e aftësisë.

(Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, Neni 40)

Për më tepër, gjithëpërfshirja është prioriteti i parë kryesor i Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK) dhe Planit të Veprimit të tij të vitit 2017 dhe një nga parimet kryesore të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (KKK) 2017. Një numër udhëzimesh administrative janë krijuar për të mbështetur zbatimin e ligjeve dhe për të siguruar udhëzime për komunitat dhe shkollat, duke përfshirë shkollat e mesme të larta.

4. Sfidat në shkollat e mesme të larta në plotësimin e nevojave të nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara

Sipas rezultateve të "vlerësimit të nevojave të veçanta arsimore në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë" i kryer nga projekti INCLUDE në nëntor 2020, sfidat në shkollat e mesme të larta për gjithëpërfshirjen e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara janë evidentuar si vijon:

- kushtet e shkollës (p.sh. infrastruktura) janë të dobëta dhe nuk janë të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuara,
- mësimdhënësit nuk janë të trajnuar se si t'i plotësojnë nevojat e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara në klasat e tyre të rregullta,
- mësimdhënësit nuk janë të trajnuar për të bërë përshtatjet dhe modifikimet në kurrikulë,
- mungojnë shërbimet e mjaftueshme mbështetëse,
- mungojnë materiale dhe pajisje të përshtatura për të nxënë /mësimdhënie.

Këto sfida do të trajtohen në kapitujt në vijim.

Ofrimi i arsimit në shkollat e mesme të larta të përgjithshme bazohet në Kornizën e Re të Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar (KKK). Ajo e përcakton të nxënësit dhe zhvillimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve duke marrë parasysh nevojën e përgatitjes së të rinjve për të marrë përgjegjësi për jetën e tyre, për të marrë pjesë në shoqëri si qytetarë aktiv dhe kompetentë, dhe për t'u angazhuar suksesshëm në konkurrencën e tregut të punës. Prandaj, nxënësit do të ekspozohen ndaj një procesi më sfidues të marrjes së njohurive dhe zhvillimit të potencialit të tyre intelektual, emocional dhe fizik. Kjo mund të shkaktojë sfida dhe barriera për disa nxënës me NVA dhe aftësi të kufizuara.

Synimi i arsimit të mesëm të lartë të përgjithshëm është të përgatisë nxënësit për arsimin universitar. Rezultatet përfundimtare të të nxënësit përcaktohen në kurrikulën bazë të KKK-së dhe standardet kërkojnë aftësi kognitive relativisht të larta nga nxënësit. Në përfundim të shkollimit, nxënësit demonstrojnë njohuritë e tyre në provimet e maturës kombëtare, andaj në arsimin e mesëm të lartë të drejtimin të përgjithshëm, hapësira për modifikim të kurrikulës është mjaftë e kufizuar.

Sidoqoftë, përshtatjet e ndryshme lehtësojnë dhe mbështesin nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara që të jenë po aq të suksesshëm në arsimimin e tyre sa çdo nxënës tjetër.

Përfshirja e vetëm janë nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale, pasi që ata kanë vështirësi të shumfishta në nxënien e gjërave të reja, përshkak të shkathtësive të dobëta njohëse dhe vështirësive në të menduarit abstrakt. Prandaj, rekomandohet shumë që këta nxënës të udhëzohen të zgjedhin profilin e AAP-së të përshtatshëm me aftësitë e tyre.

Arsimi i mesëm i lartë profesional synon përgatitjen për tregun e punës. Parimet për arsimin dhe aftësimin profesional të parapara në Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (2013) janë: 1) gjithëpërfshirja; 2) qasja, transferi dhe progresi; 3) mësimi teorik dhe praktika profesionale; 4) nevojat aktuale dhe të ardhshme të ekonomisë; dhe 5) mbështetja e zhvillimit të karrierës si pjesë e integruar e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Kualifikimet e AAP-së bazohen në kërkesat e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, kurrikulës bazë të AAP-së dhe Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (PSAK 2017–2021, f. 80).

Disa nga aftësitë e kufizuara mund të shkaktojnë kufizime në kryerjen e ca detyrave. Andaj, gjatë përzgjedhjes së profilit në arsimin profesional, nxënësi me NVA dhe aftësi të kufizuara duhet të pajiset me udhëzime dhe këshillime në karrierë (shih kapitullin 5.3.3.) për t'u siguruar që profili i zgjedhur është i përshtatshëm për nxënësin.

Shembull nga arsimi profesional në Finlandë

- Gjendja shëndetësore e aplikantit ose aftësia për të funksionuar nuk duhet të jetë pengesë për pranim, por kërkesat e sigurisë që lidhen me kualifikimin për të kryer detyra praktike në punë duhet të përmbushen.
- Kërkesat shëndetësore sigurohen nga Agjencia Kombëtare Finlandeze për Arsim dhe janë të disponueshme në internet.
- Ofruesi i trajnimit duhet të informojë aplikantin për kërkesat mjekësore dhe kushtet e tjera që i bashkëngjiten kualifikimit.
- Shembulli 1: Kërkesat shëndetësore për kualifikim në fushën sociale dhe të mirëqenies përfshijnë barriera në pranim: psikoze, depresion, gjendje fizike ose aftësi e kufizuar që pengon kryerjen e punës praktike, alkool ose abuzim me drogën, për kualifikimin që çon në punë me fëmijë dhe të rinj nuk lejohet asnjë dosje penale;
- Shembulli 2: Kërkesat shëndetësore për kualifikimin në pylltari; ekspertizë në transportin e makinave pyjore përfshijnë barriera në pranim: diabeti i trajtuar me insulinë, epilepsia ose sëmundje të tjera dhe çrregullime të sistemit të ekuilibrit, dëmtim të shikimit ose dëgjimit që nuk mund të korrigjohen me pajisje ndihmëse, sëmundje kardiovaskulare, sëmundje të frymëmarrjes që kufizojnë qëndrueshmërinë fizike dhe përballimin e punës në natyrë, sëmundje muskulore-skeletore , çrregullim mendor, përdorim të drogës ose abuzim me substanca.
- Këshilltarët e karrierës kanë një rol të rëndësishëm në udhëzimin e nxënësve të klasës 9 për të zgjedhur rrugën e përshtatshme të arsimit të mëtejshëm dhe më tej gjatë shkollimit të AAP-së

Rekomandime

- Kërkesat minimale shëndetësore duhet të vendosen për secilin profil të AAP-së aty ku ato janë të nevojshme. Kjo është e nevojshme në mënyrë që të shmangët një situatë që nxënësi me NVA ose aftësi të kufizuara të mos i plotësojë kërkesat e sigurisë për të kryer detyra praktike në punë.
- Bazuar në aftësitë individuale dhe performancën e nxënësit, mësimmësimit të AAP-së mund të vendosin se cilat module mund të kompletohen dhe cilat prej tyre duhet të modifikohen.
- Nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara të cilët nuk mund t'i plotësojnë të gjitha pjesët e kualifikimeve, duhet të marrin një certifikatë që tregon dhe përshkruan pjesët e kualifikimit të përfunduar. Kjo mund t'u ndihmojë atyre që të gjejnë një punë dhe të punojnë, nëse jo si profesionist plotësisht të kualifikuar, por p.sh. në detyra ndihmëse.
- Në rast se nxënësi me NVA dhe aftësi të kufizuara nuk i ka aftësitë e kërkuara për të vazhduar mësimet, ofruesi i arsimit do ta udhëzojë nxënësin në drejtime të përshtatshme për të.
- Programi arsimor mund të modifikohet në mënyrë që nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara të arrijnë kualifikimet sa më të përafërta me nxënësit e tjerë.
- Ofruesi i arsimit është përgjegjës për hartimin e kriterëve të modifikuara të vlerësimit për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara. Ata që krijojnë kriteret e vlerësimit duhet të jenë të vetdijshëm për aftësitë dhe kompetencat kryesore në secilin profesion dhe mënyrën se si nxënësit janë në gjendje t'i arrijnë ato. Parimi parësor është të ndihmohet nxënësi me NVA dhe aftësi të kufizuara për të arritur të njëjtat objektiva mësimore si të gjithë të tjerët.
- Në rast se nxënësi me NVA dhe aftësi të kufizuara pavarësisht mbështetjes shtesë nuk arrijnë nivelin e kriterëve të caktuara, mund të modifikohen objektivat mësimore dhe kriteret e vlerësimit. Kur nxënës të tillë diplomojnë, ata do të marrin një certifikatë të shkollimit dhe objektivat e modifikuara do të regjistrohen në PIA të nxënësit.

5. Shërbimet e mbështetjes për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta rregullta në Kosovë

Përfshirja e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara kërkon që të ofrohet mbështetje përkatëse për nxënësin bazuar në nevojat individuale të nxënësve (Ligji Nr. 04/L-032). Në Kosovë, shërbimet mbështetëse funksionojnë në tri nivele: qendore, komunale dhe shkollore. Figura 1 jep një pasqyrë të shërbimeve ekzistuese mbështetëse për plotësimin e nevojave të veçanta arsimore të nxënësve në arsimin parauniversitar në Kosovë.




FIGURA 1. Shërbimet mbështetëse (Udhërrëfyesi për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen për arsimin parauniversitar në Kosovë, 2017)

Shërbimi mbështetës për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara me role dhe detyra të akterëve të ndryshëm janë paraqitur në kapitujt në vijim.

5.1. Mbështetja në nivelin qendror

Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar "përgjegjësia e Ministrisë është të sigurojë politika gjithëpërfshirëse për përfshirjen e personave me nevoja të veçanta. Ministria u ofron ndihmë teknike komunave për të siguruar përshtatshmërinë e ndërtesave shkollore dhe të pajisjeve sipas standardeve ndërkombëtare për shëndet dhe siguri, si dhe për mbrojtje të mjedisit, për të siguruar qasje të nxënësve dhe punonjësve me aftësi të kufizuara dhe pajisjet ndihmëse për përkrahjen e arsimit gjithëpërfshirës. (Ligji Nr.04/L-032)

MASHTI është përgjegjëse për:

- Zhvillimin e politikave për arsimin gjithëpërfshirës, me theks të veçantë për fëmijët me NVA;
- Menaxhimin e stafit që punon me fëmijë me NVA në Qendrat Burimore;
- Koordinimin dhe planifikimin e aktiviteteve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës me institucione, komuna, organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare;
- Monitorimin e cilësisë së procesit arsimor të ofruar për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

5.1.1. Qendrat Burimore

Qendrat burimore janë ish-shkolla speciale të cilat janë transformuar për të funksionuar jo vetëm si shkolla speciale, por edhe si qendra burimore për t'u siguruar shërbime mbështetëse nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara dhe mësimdhënësve të tyre në shkollat e rregullta në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Shërbimet e pesë qendrave burimore ekzistuese mbulojnë të gjithë vendin.

Qendrat burimore kanë tri funksione kryesore:

- 1) Ofrimi i mbështetjes për shkollat e rregullta ;
- 2) Krijimi i materialeve specifike për mësimdhënie dhe nxënie për përdorimin e shkollave të rregullta me nxënës me NVA në shkollat e rregullta; dhe
- 3) Ofrimi i trajnimeve për mësimdhënësit në shkollat e rregullta.

Detyrat e shërbimeve mbështetëse:

- Zhvillimi, përpilimi dhe shpërndarja e materialeve mbështetëse për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta;
- Organizimi i trajnimeve të akredituara për mësimdhënësit me nxënës me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- Bashkëpunimi me ekipet komunale të vlerësimit në lidhje me vendosjen dhe mbështetjen për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- Shërbimet e mësimdhënësit udhëtues .

Mësimdhënësit udhëtues janë anëtarë të stafit të QB-ve dhe kanë rol të rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes për shkollat e rregullta. Këta mësimdhënësit udhëtues vizitojnë shkollat e rregullta në të gjithë Kosovën që të:

- ofrojnë mbështetje në zhvillimin e PIA-ve të nxënësve;
- ofrojnë këshilla për mësimdhënësit në shkollat e rregullta për të mësuar nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- ofrojnë pajisje për mësimdhënie për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- identifikojnë nevojat për trajnim të mësimdhënësve në shkollat e rregullta;
- identifikojnë nevojat për materiale didaktike në shkollat e rregullta.

Qendrat burimore si ofrues trajnimesh

MASHTI ka autorizuar QB-të të ofrojnë programe të akredituara trajnimi për mësimdhënësit me nxënës me NVA dhe aftësi të kufizuara. Ato programe të trajnimit ndryshojnë kohë pas kohe në bazë të nevojave të mësimdhënësve.

Rekomandime:

- Numri i mësimdhënësve udhëtues duhet të rritet.
- Mësimdhënësit udhëtues duhet të jenë të përgatitur për t'u shërbyer shkollave të rregullta të mesme të larta dhe të njihen me profile të ndryshme të AAP-së.
- Duhet të rritet numri i personelit në QB-të për të punuar për shërbimet mbështetëse.
- Fondet për trajnime duhet të rriten.
- Duhet të rritet ofrimi i trajnimit për shkollat e mesme të larta të rregullta për tema që lidhen me PIA-n, krijimi i materialeve, përmbushja e nevojave të nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara në klasat e rregullta.

5.2. Mbështetja për shkollat e mesme të larta në nivelin komunal

Ligji për Arsimin Parauniversitar kërkon nga komunat që të ofrojnë arsim gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit, përfshirë nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara siç përshkruhet në Kapitullin 3. Në nivelin komunal shërbimet e mbështetjes për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara përbëhen nga shërbimet e ekipit komunal të vlerësimit që koordinohet nga drejtorja komunale e arsimit – DKA.

Rekomandim:

- Secila shkollë e mesme e lartë të ketë një mësimitdhënës mbështetës, një psikolog shkolle dhe një këshilltar për orientim në karrierë dhe asistent për nxënës me NVA.
- Në rast se kjo nuk do të jetë e mundur, rekomandohet që Drejtoritë Komunale të Arsimit të punësojnë secilin prej këtyre profesionistëve për të ofruar shërbime për dy shkolla në vend të njëjës.

Përgjegjësitë e këtyre profesionistëve janë paraqitur në kapitullin 5.3. "Shërbimet mbështetëse në nivel shkolle".

Drejtoritë komunale të arsimit implementojnë politikën e MASHTI duke përfshirë edhe arsimimin e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara. Ata koordinojnë dhe planifikojnë aktivitete me ekipet komunale vlerësuese; asistojnë në ngritjen e pjesëmarrjes së nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe e mbështesin organizimin e arsimit të nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara në komunat e tyre përkatëse.

Për më tepër, DKA i kanë këto përgjegjësi:

- Të bashkëpunojnë me qendrat burimore dhe institucionet e tjera në mënyrë që të krijohen kushte për arsim gjithëpërfshirës;
- Të planifikojnë dhe koordinojnë trajnimin profesional të mësimitdhënësve për arsimin gjithëpërfshirës;
- Të mbikëqyrë dhe të koordinojë punën e mësimitdhënësve që punojnë me nxënësve me NVA dhe AK;
- Të bashkëpunojnë ngushtë me MASHTI-in;
- Të planifikojnë dhe koordinojnë procesin e identifikimit të fëmijëve me NVA dhe AK;
- Të bashkëpunojnë me shkollat në mënyrë që të bëjë analizat e nevojave të nxënësve me NVA dhe AK;
- Të sigurojë ndërlidhjen e shkollës, mësimitdhënësit dhe nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara me shërbimet mbështetëse të qendrave burimore (shih kapitullin 5.1);
- Të koordinojnë dhe mobilizojnë burimet e nevojshme për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta;
- Të bashkëpunojnë me shkollat e mesme të larta për të ndarë dhe shfrytëzuar në mënyrë efektive burimet njerëzore dhe financiare
- Të përkujdeset rreth organizimit të transportit të duhur në shkollë për fëmijët me NVA dhe AK.
- Të mbështesë shkollat e mesme të larta në zhvillimin e planeve mbështetëse për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara.

Plani mbështetës mund të përgatitet për një vit shkolle ose për një periudhë më të shkurtër kohore në varësi të nevojave të nxënësit. Ai mund të hartohet:

- në bashkëpunim me QB-në e zgjedhur dhe shkollën e mesme të lartë me nxënësin me NVA dhe aftësi të kufizuara; ose
- në bashkëpunim me stafin ekzistues mbështetës (psikolog, mësues mbështetës, asistent për nxënësit me NVA) në shkollat e mesme të larta; ose
- nga ekipi mbështetës i shkollës i përbërë nga psikolog, pedagog, mësimitdhënës mbështetës, asistent për nxënësit me NVA dhe këshilltar për orientim në karrierë.

Gjithashtu, DKA mund të mbështesë shkollat me sugjerime dhe ide se si të përmirësohen kushtet dhe mjedisi i shkollës për ta bërë atë më të qasshëm dhe miqësor për nxënësit. Kjo mund të nënkuptojë përmirësimin e kushteve fizike të shkollës duke ndërtuar pjerrina, duke i kushtuar vëmendje ndriçimit të duhur, tualeteve të pastra dhe të qasshme dhe kushte të tjera fizike në shkollë.

5.2.1. Ekipet komunale të vlerësimit

Secila komunë, ose në bashkëpunim me një komunë tjetër, duhet të krijojë një ekip vlerësimi dhe mbështetjeje profesionale për nevojat e veçanta arsimore për t'u siguruar mbështetje të jashtme institucioneve arsimore dhe trajnuese për të siguruar këshillim dhe udhëzim për mësimitdhënësit, nxënësit dhe prindërit. (Ligji për Arsimin Parauniversitar, Neni 41.)

Nxënësit nga arsimi i mesëm i lartë, kur është e nevojshme, kanë të drejtë për shërbimet e ekipit komunal të vlerësimit.

Qëllimet e vlerësimit janë:

- vlerësimi i aftësive, interesave dhe nevojave të nxënësve;
- dhënia e rekomandimeve për metodat e mësimdhënies, mjetet ndihmëse dhe përshtatjet tjera të nevojshme për mësimdhënie dhe mirëqenie të nxënësve;
- përcaktimi i nevojave për pajisje të posaçme të nevojshme për mësim; dhe
- dhënia e rekomandimeve për vendosjen e nxënësve.

Kërkesa për vlerësim profesional mund të iniciohet nga prindi, drejtori i shkollës me kërkesën e një mësimdhënësi, DKA-së, eksperti mjekësor dhe drejtori i Qendrës Komunale për Punë Sociale. Kërkesa për vlerësim duhet t'i dorëzohet DKA-së.

Udhëzimi Administrativ 16/2017 përcakton procedurat me të cilat kryhet vlerësimi pedagogjik i fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe mënyra e funksionimit të ekipeve të vlerësimit.

Përbërja e ekipit të vlerësimit përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm të përhershëm:

- Zyrtari komunal i arsimit gjithëpërfshirës i cili është edhe koordinatori i ekipit;
- Psikologu;
- Pedagogu/pedagogu special;
- Punëtori social;
- Mësimdhënësi mbështetës ose mësimdhënësi udhëtues ;
- Personeli tjetër bazuar në nevojat dhe llojin e aftësisë së kufizuar të nxënësit;
- Anëtarët e tjerë të ftuar nga ekipi bazuar në nevojat; dhe
- Mësimdhënësi/kujdestari i klasës

Përveç kësaj, ekspertë të tjerë mund të ftohen në ekipin e vlerësimit bazuar në nevojat individuale dhe karakteristikat e nxënësve, p.sh. mësimdhënësi i nxënësve dhe ekspertë të tjerë.

Prindi duhet të jetë i pranishëm dhe të konsultohet gjatë gjithë kohës së vlerësimit.

Kompetencat e ekipit të vlerësimit përmbajnë p.sh. sa vijon:

- Kryerja e vlerësimit pedagogjik;
- Përcaktimi i institucionit arsimor ku do të ndjekë mësimet nxënësi;
- Vendosja për llojin e mësimdhënies që do të ofrohet për nxënësin;
- Vendosja për pajisjet ndihmëse dhe pajisjet e nevojshme për nxënësin;
- Vendosja për shërbimet e rehabilitimit për nxënësin;
- Vendosja për transportin e duhur për nxënësin.

Të gjithë nxënësit që kanë marrë një vendim mbi arsimin me nevoja të veçanta nga ekipi i vlerësimit duhet të kenë një plan individual arsimor (PIA). Ekipi i vlerësimit mund të japë rekomandime për përmbajtjen e PIA-s. Qëllimi kryesor i vlerësimit është të identifikojë nevojat dhe të ofrojë burime për mbështetjen.

Edhe pse, deri më tani ekipet e vlerësimit nuk janë përfshirë shumë në vlerësimin e nxënësve me NVA në arsimin e mesëm të lartë, mandati i tyre është t'u shërbejnë të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar.

Ekipet e vlerësimit duhet të mbështesin nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta përmes:

- dhënies së rekomandimeve për hartimin e një plani individual arsimor (PIA) për nxënësit me NVA dhe AK,
- dhënies së rekomandimeve për metodat e mësimdhënies që do të ofrohen për nxënësit me NVA, dhe AK
- vendosjes për pajisjet ndihmëse dhe pajisjet e nevojshme për nxënësit,
- vendosjes për shërbimet e rehabilitimit të nevojshme për fëmijën në shkollën e mesme të lartë,
- dhënies së rekomandimeve për llojin e mbështetjes dhe masat e sigurisë të nevojshme për fëmijën gjatë periudhës së praktikës profesionale.
- Dhënies së rekomandimit për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara për përzgjedhjen e profileve të mundshme.

5.3. Mbështetja në nivel shkolle

Mësimdhënia e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta të rregullta kërkon që shkollat të kenë shërbime dhe personel përkatës mbështetës për të përmbushur nevojat e nxënësve. Ky kapitull paraqet shërbimet kryesore të mbështetjes që mund të marrin nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollën e mesme të lartë. Këto përfshijnë shërbimet e mësimdhënësve mbështetës, psikologëve, këshilltarëve për orientim në karrierë, ekipeve mbështetëse, asistentëve për nxënësit me NVA, mbështetje gjatë punës praktike dhe përdorimit të Planeve Individuale Arsimore.

5.3.1. Mësimdhënësi mbështetës

Mësimdhënësi mbështetës është një profesionist i arsimit që punon në shkolla të rregullta dhe është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes për arsimimin e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara. Mësimdhënësi mbështetës nuk është përgjegjës për dhënie të një lënde të caktuar, por ai/ajo është përgjegjës për mbështetjen e të gjithë nxënësve që përjetojnë pengesa në mësim të shkaktuara nga NVA, aftësia e kufizuar ose ndonjë gjendje tjetër.

Detyrat e mësimdhënësve mbështetës në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të rregullta përbëhen nga sa vijon:

- Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- Planifikimi dhe organizimi i bashkë-mësimdhënies me mësimdhënësit që japin mësim në klasat rregullta ku ka nxënës me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- Puna individuale me nxënësin me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- Zhvillimi i planit individual arsimor në bashkëpunim me stafin tjetër mbështetës dhe nxënësin;
- Këshillimi dhe asistimi i mësimdhënësve të rregullt se si të punojnë me nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- Në bashkëpunim me mësimdhënësit e rregullt, të zhvillojnë materiale alternative për mësimdhënie që do të përdoren në arsimimin e nxënësve me NVA dhe AK;

Detyrat e mësimdhënësve mbështetës në shkollat e mesme të larta përbëjnë si vijon:

- Ofrimi i mbështetjes në hartimin e PIA-s për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- Këshillimi dhe mbështetja e mësimdhënësve të tjerë të AAP-së se si të mësojnë nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e AAP-së;
- Mbështetja e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara në arritjen e qëllimeve të kurrikulës dhe qëllimeve të modifikuara bazuar në PIA;
- Mbështetja e mësimdhënësve të AAP-së në modifikimin e detyrave në module të caktuara bazuar në nevojat specifike të nxënësve me NVA;
- Modifikimi dhe krijimi i materialeve mësimore alternative që do të përdoren për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- Të planifikojë me kujdes në bashkëpunim me instruktorin ose mësimdhënësin e praktikës profesionale praktikën e punës për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara bazuar në nevojat dhe aftësitë e tyre;
- Të mbështesë nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuar gjatë punës së tyre praktike në shkollat e AAP-së;
- Të kujdeset për sigurinë fizike dhe psikologjike për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara gjatë punës së tyre praktike.

Rekomandime:

- Deri më tani, mësimdhënësit mbështetës janë punësuar vetëm në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të Kosovës. Megjithatë, shumica e shkollave të mesme të larta në Kosovë tashmë kanë dhe në të ardhmen do të kenë edhe më shumë nxënës me NVA dhe aftësi të kufizuara, mësimdhënësit mbështetës janë shumë të nevojshëm edhe në shkollat e mesme të larta.
- Secila shkollë e mesme e lartë dhe posaçërisht shkolla e AAP-së të ketë mësimdhënësin e vet mbështetës.
- Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë DKA duhet të punësojë një mësimdhënësi mbështetës i cili/e cila do të shërbente në dy shkolla në komunë. Kjo do të mund të bëhej përmes rikualifikimit të mësimdhënësve që mbesin pa normë.
- Në shkollat e AAP-së, profili i mësimdhënies i mësimdhënësit mbështetës mund të jetë një mësimdhënësi lëndor i AAP-së ose ndonjë personel tjetër mësimor me përvojë pune dhe motivim për të punuar me nxënës me NVA dhe AK.
- Programi i trajnimit duhet të përshtatet për mësimdhënësit mbështetës në shkollat e AAP.

5.3.2 Psikologu i shkollës

Psikologu i shkollës është një anëtar i stafit i punësuar në shkollë dhe konsiderohet si personel profesional jo-mësimdhënës (UA Nr. 34/2014). Punët dhe detyrat e psikologëve shkollorë janë dhënë si më poshtë:

- Dhënia e kontributit në procesin mësimor dhe promovimi i zhvillimit emocional, shoqëror dhe personal të nxënësit
- Asistimi dhe ndihma në identifikimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në të nxënë, nxënësve të talentuar dhe identifikimi dhe ofrimi i seancave të ndryshme të këshillimit individual ose në grup për nxënësit
- Puna me nxënës në zhvillimin e strategjive për mësim, zhvillimin shoqëror dhe personal, vetë-monitorimin dhe shkathtësitë e tjera njohëse
- Asistimi në përgatitjen e programit mësimor individual të nxënësit
- Bashkëpunimi me mësimdhënësit dhe anëtarët e tjerë të stafit në shkollë
- Ofrimi i konsultimeve për prindërit dhe mësimdhënësit dhe personelin tjetër të shkollës në përmirësimin e mjedisit mësimor dhe shëndetit të nxënësit
- Ofrimi i konsultimeve për zbatimin e praktikave më të mira të nxënës dhe mësimdhënies në bashkëpunim me pedagogun e shkollës
- Ofrimi i informatave dhe trajnimit në lidhje me zbatimin e teorive mësimore.

Rekomandim:

- Roli i psikologut të shkollës në nivelin e mesëm të lartë është shumë i rëndësishëm për funksionimin e mirë të nxënësve andaj një psikolog me orar të plotë duhet të punësohet në secilën shkollë të mesme të lartë

5.3.3. Këshilltari për orientim në karrierë

Qëllimi i orientimit në karrierë është të mbështesë nxënësit gjatë mësimave të tyre dhe të sigurojë që ata të fitojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për të kaluar në studime të mëtejshme dhe punësim.

Ligji Nr. 04/L-138 për AAP në Kosovë (2013) kërkon “mbështetjen për zhvillim të karrierës së nxënësve si pjesë e integruar e të nxënës gjatë gjithë jetës”, dhe udhëzimi dhe këshillimi i karrierës duhet të jenë pjesë integrale e të gjitha programeve të ofruara nga institucionet e AAP-së.

Në vitin 2017, është zhvilluar dhe verifikuar standardi i profesionit të nivelit të pestë të këshilltarit për orientim në karrierë, dhe gjithashtu u aprovua nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit (AKK-ja). Kualifikimi u miratua nga AKK-ja dhe është ofruar për grupin e parë prej 40 kandidatësh.

Detyrat e këshilltarëve të orientimit në karrierë përfshijnë p.sh.:

- Informacioni mbi karrierën: ndërgjegjësimi i nxënësve dhe të diplomuarve për profesione të ndryshme, mundësi karriere, oferta pune, situata dhe trendet e tregut të punës, etj.; sigurimi i informatave kthyesë për rezime dhe këshillimi i nxënësve për të gjitha aspektet e procesit të kërkimit të punës/praktikës.
- Zhvillimi i karrierës: përgatitja, organizimi dhe ofrimi i kurseve afatshkurtra për nxënësit në tema të ndryshme që lidhen me karrierën.
- Rekrutimi i punëdhënësit: tërheqja e punëdhënësve për të bashkëpunuar me shkollën dhe qendrën e karrierës, përmes kontakteve në terren, rrjeteve, mësimdhënësve dhe ish-nxënësve. Inkurajimi i përfshirjes së punëdhënësit në aktivitetet dhe programet e Qendrës së Karrierës; promovimin e praktikës dhe mundësive të mësimit të bazuar në punë të ofruara nga punëdhënësit.

Në Kosovë janë themeluar 15 qendra të karrierës. Trembëdhjetë prej tyre janë qendra në shkollë që funksionojnë brenda shkollave të AAP-së. Një qendër e karrierës funksionon në Universitetin e Prishtinës dhe një qendër karriere është themeluar nga DKA në Prishtinë.

Qendrat e karrierës të krijuara në shkollat e AAP-së punësojnë dy këshilltarë të orientimit në karrierë: njëri përgjegjës për orientim në karrierë dhe tjetri përgjegjës për ndërlidhjen me bizneset.

Mbështetja nga këshilltarët për orientim në karrierë është shumë e nevojshme për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e AAP-së. Këshilltarët për orientim në karrierë mbështesin nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në zgjedhjen e profilit të përshtatshëm, kërkimin e punës dhe mbajtjen e nxënësve të motivuar gjatë arsimimit të tyre.

Detyrat e këshilltarëve për orientim në karrierë në mbështetjen e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara do të konsistojnë sikur janë përshkruar më poshtë:

- Mbështetja e nxënësit me NVA për të zgjedhur profilin e duhur gjatë regjistrimit në shkollën e AAP-së duke ofruar informacion të detajuar në lidhje me disa profile të caktuara dhe mundësitë për të gjetur punë pas diplomimit
- Mbështetja e ekipit të PIA-s
- Mbështetja e nxënësve me NVA dhe AK në arritjen e qëllimeve të PIA-s
- Mbështetja e nxënësve me NVA dhe AK në kërkimin e punës pas diplomimit

Rekomandim:

- Çdo shkollë e AAP-së të ketë një këshilltar për orientim në karrierë i cili do të mbështesë nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara. Këta këshilltarë për orientim në karrierë kanë nevojë për trajnim të përshtatur për ta se si të udhëzojnë dhe mbështesin nxënësit me NVA.

5.3.4. Asistenti për nxënësit me NVA

Asistenti për nxënësit me NVA është profesion i ri në Kosovë. Përvojat e asistentëve për fëmijët me NVA në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta kanë qenë të shkëlqyera, dhe shërbimet e tyre në shkollat e mesme të larta të rregullta janë gjithashtu shumë të nevojshme. Në shkollat e AAP-së, roli i një asistenti gjatë praktikës së punës do të ishte shumë i rëndësishëm që nxënësi me NVA të jetë i suksesshëm.

Detyrat e asistentëve për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara ndryshojnë në varësi të nevojave individuale të nxënësit, nevojave të klasës dhe dëshirave të mësimit.

Detyrat e asistentit për nxënësit me NVA mund të përmbajnë p.sh. sa vijon:

- Ofrimi i ndihmës teknike për nxënësin me NVA dhe aftësi të kufizuara, mësimit dhe tërë klasën në përputhje me nevojat ekzistuese;
- Ofrimi i mbështetjes personale për nxënësin me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- Asistimi në përgatitjen e materialeve mësimore të nevojshme për nxënësin me NVA;
- Të siguruarit që pajisjet dhe mjetet ndihmëse të nevojshme ekzistojnë dhe funksionojnë;
- Asistimi i nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkrim, lexim, ushtrim, shpjegime, përgatitje të çantës, lëvizshmëri etj.;
- Asistimi i nxënësit në marrjen e shënimeve, shkrimin e njëjësive mësimore, fjalët kyçe, konceptet ose veprimet e reja në matematikë kur është e nevojshme;
- Kur është e nevojshme, sjellja e nxënësit në shkollë, mbështetja e nxënësit gjatë ecjes/përdorimit të karrocës ose kur nuk mundet të lëvizë vet;
- Të mbështesë në zbatimin e punës praktike sipas udhëzimeve të mësimit dhe bazuar në nevojën e nxënësit.

Rekomandim:

- Të punësohen asistentë për nxënësit me NVA në shkollat e mesme të larta
- Numri i asistentëve të nevojshëm varet nga numri i nxënësve me aftësi të kufizuara dhe lloji i aftësive të kufizuara që kanë nxënësit.

5.3.5. Ekipi mbështetës

Ekipi mbështetës përbëhet nga mësimit mbështetës, psikologu i shkollës, asistenti për fëmijët me nevoja të veçanta dhe këshilltari për orientim në karrierë. Detyra kryesore e ekipit mbështetës është që të planifikojë dhe ofrojë mbështetje për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta.

Rekomandim:

- Në rast të mungesës së fondeve dhe burimeve në komunë për të siguruar një mësimit mbështetës dhe/ose psikolog shkollë për secilën shkollë, rekomandohet të caktohet një mësimit mbështetës/psikolog shkollë për dy shkolla.
- Për të ofruar mbështetje të koordinuar dhe efektive për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara dhe mësimit mbështetës e tyre, rekomandohet krijimi i ekipeve mbështetëse në secilën shkollë të mesme të lartë.

5.3.6. Mbështetja gjatë punës praktike në AAP

Rekomandime:

- Instruktorët e punës në vendet e punës praktike duhet të aftësohen për të përmbushur nevojat e nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara. Trajnimi duhet të jetë i orientuar praktikisht, i kryer individualisht në vendin e punës dhe duhet të përshtatet me nevojat individuale të nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara.
- Nxënësi me NVA së bashku me mësimpldhënësin e AAP-së dhe mësimpldhënësin mbështetës duhet të udhëzojnë instruktorin e punës se çfarë lloj mbështetjeje nevojitet për nxënësin.
- Mësimpldhënësi nga shkolla e AAP-së duhet të mbajë kontakte dhe të sigurojë mbështetje të vazhdueshme për nxënësin dhe instruktorin e punës me telefonata dhe vizita në vendin e punës. Mbështetja duhet të jetë e shënuar në PIA të nxënësit.

5.3.7. Plani individual arsimor (PIA)

Ligji për Arsimin Parauniversitar (Neni 41) përcakton që përmbajtja e mësimpldhënies për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore përcaktohet në planet individuale arsimore (PIA).

PIA është një dokument pedagogjik që përmbanë përshkrimin e nevojave të veçanta arsimore të nxënësit dhe mënyrën se si duhet të organizohet mbështetja për nxënësin. Kjo përmbanë p.sh.:

- identifikimin e nxënësit dhe informacionin për atë;
- nivelet e performancës së nxënësit;
- pikat e forta dhe sfidat e nxënësit;
- aftësitë dhe nevojat e nxënësit;
- rezultatet përfundimtare ose qëllimet e pritshme të nxënësit në mësim;
- metodat, materialet dhe strategjitë e mësimpldhënies;
- shërbimet mbështetëse të nevojshme;
- afatet kohore për rishikimin e PIA-së.

Procedura për zbatimin dhe vlerësimin e PIA-s rregullohet në Udhëzimin Administrativ Nr. 18/2013 për përdorimin e PIA me përmbajtjen vijuese:

- Përkufizimi i PIA;
- Përcakton se cilët nxënës kanë të drejtë për një PIA;
- Përcakton se çfarë duhet të përmbajë një PIA;
- Përcakton se si një PIA duhet të rishikohet dhe vlerësohet;
- Përcakton se si duhet të vlerësohen nxënësit me PIA.
- Identifikimi dhe mirëmbajtja e dokumentacionit;
- Monitorimi i përdorimit të PIA-ve.

Udhëzuesi për planin individual arsimor u publikua nga MASHT-i në vitin 2011 dhe është zhvilluar një instrument për monitorimin e implementimit të PIA-s. (https://resourcecentre.savethechildren.net/node/15078/pdf/plani_individual_i_arsimit.pdf)

Plani individual arsimor duhet të përgatitet për nxënës që janë vlerësuar nga ekipi komunal i vlerësimit dhe kanë marrë vendimin për arsimin me nevoja të veçanta. Për më tepër, të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën e mesme të lartë duhet të kenë një PIA.

Nëse për shkak të kufizimeve të shkaktuara nga NVA dhe aftësia e kufizuar, nxënësi nuk mund të arrijë qëllimin e përbashkët dhe t'i plotësojë të gjitha modulet, atij/asaj duhet t'i hartohet PIA. PIA duhet t'i përmbajë objektivat e modifikuara në bazë të nevojave dhe shkathtësive të nxënësit dhe poashtu përshkrimin e mënyrave dhe metodave të vlerësimit të cilat ndryshojnë nga bashkëmoshatarët e tij/saj pa NVA.

PIA në shkollat e mesme të larta duhet të hartohet nga një ekip mbështetës. Ekipi për të përgatitur PIA-n duhet të përbëhet nga mësuesi i lëndës përkatëse ose mësuesi i AAP-së, instruktori, psikologu shkolle, mësuesi mbështetës dhe një asistent për fëmijë me nevojë të veçanta arsimore (në rast se ka një asistent). Prindërit e nxënësit gjithashtu mund të kontribuojnë në hartimin e PIA-së dhe duhet të informohen për PIA-n e nxënësit të tyre. Përbërja e ekipit të PIA-s mund të ndryshojë nga një rast në tjetrin në varësi të disponueshmërisë së burimeve njerëzore në shkollën e mesme të lartë.

Trajnimi i PIA-s mund të organizohet nga qendrat burimore dhe ofruesit e tjerë të akredituar për trajnim.

5.3.7. Madhësia e klasës

Numri maksimal i nxënësve me NVA në një klasë të rregullt në një shkollë të AAP është tre, dhe në rastin kur ka një nxënës me NVA në klasë, duhet të ketë dy nxënës të rregullt më pak në klasë. (AI Nr. 22/2013.)

6. Udhëzime për shkollat dhe mësimdhënësit se si të përfshijnë dhe mbështesin nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta të rregullta

Arsimi gjithëpërfshirës synon të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit. Ideja është që të gjithë nxënësit të mësojnë dhe të përparojnë së bashku në të njëjtin mjedis mësimor ku plotësohen nevojat individuale të secilit nxënës.

Gjithëpërfshirja e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta duhet të përgatitet mirë. Kjo kërkon që të ndërtohen mekanizma mbështetëse jashtë dhe brenda shkollës (të përshkruara në kapitujt e mëparshëm) dhe ndryshimet të bëhen brenda shkollës, në mënyrë që të sigurohet qasja dhe përmbushja e nevojave individuale të një nxënësi me NVA dhe aftësi të kufizuara. Qasja nuk i referohet vetëm mjedisit fizik. Ajo i referohet edhe qasjes në kurrikulë.

Mësimdhënësit kanë rol kyç në gjithëpërfshirjen e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara dhe për ta bërë të nxënës të tyre të suksesshëm. Mësimdhënësit duhet të trajnohen dhe mbështeten për të përmbushur nevojat e ndryshme të nxënësve dhe për të menaxhuar të gjithë klasën gjithëpërfshirëse.

Ky kapitull përshkruan:

- ndryshimet që duhet të bëhen në shkollë për të mirëpritur nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- mënyrën se si të identifikohen nxënësit me NVA;
- se çfarë akomodimesh dhe modifikimesh janë bërë për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- se si mësimdhënësit mund të menaxhojnë një klasë gjithëpërfshirëse; dhe
- se si të plotësohen nevojat dhe të mbështeten nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në mësim.

6.1. Përgatitjet në shkollë

Përgatitjet në shkollë mund të përfshijnë përshtatjet e duhura në infrastrukturën e shkollës, si p.sh:

- oborri i shkollës, shkolla, klasat dhe tualetet që të jenë të qasshme për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara;
- vendosja e mbajtëseve/parmakëve;
- ndërtimi i pjerrinave për nxënësit me dëmtime fizike;
- përmirësimi i ndriçimit dhe aplikimit të kontrastit për nxënësit me dëmtim të shikimit;
- rregullimi i klasave që të jenë miqësore për nxënësit (p.sh. madhësia optimale e klasës).

Për të plotësuar nevojat e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara, është e nevojshme që:

- të merret informacion për nxënësit dhe nevojat e nxënësit duke intervistuar nxënësin dhe prindërit, duke marrë informacion nga ish-mësimdhënësit, DKA dhe nga dokumentet p.sh. PIA paraprake, dokumente shëndetësore, teste etj.;
- të kuptohet se cilat janë sfidat në të nxënës dhe nxënësit dhe çfarë lloj përshtatje dhe mbështetje janë siguruar më herët;
- të sigurohet që burimet njerëzore të mjaftueshme janë në dispozicion në shkollë (p.sh. raporti optimal mësues-nxënës, mësimdhënësi të kualifikuar);
- të përzgjidhen mësimdhënësit dhe të trajnohen ata;
- të sigurohet që janë organizuar mekanizma të mjaftueshme mbështetëse për nxënësit dhe mësimdhënësit (p.sh. ekipi mbështetës, mësimdhënësi mbështetës, psikologu, asistentët për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara, përkthyesi i gjuhës së shenjave për nxënësit të shurdhër, shërbimet mbështetëse nga qendrat burimore);

- të bëhen gati për të bërë modifikimet e duhura në kurrikulën që të jetë e qasshme për nxënësin me NVA;
- të sigurohet se ka në dispozicion materiale të mjaftueshme të përshtatura për mësimdhënie dhe të nxënë;
- të sigurohet që pajisjet dhe mjetet ndihmëse të nevojshme janë në dispozicion;
- të sigurohet një mjedis miqësor për nxënësit ku çdo nxënës mund të ndihet i sigurt fizikisht, i sigurt emocionalisht dhe i aftësuar psikologjikisht.
- të ketë formularin e tranzicionit të mbushur nga shkolla paraprake e nxënësit.

6.2. Identifikimi i nevojave të veçanta arsimore

Identifikimi i bërë para regjistrimit në shkollën e mesme të lartë

Identifikimi i nevojave të veçanta arsimore të nxënësit shpesh bëhet para hyrjes së nxënësit në shkollën e mesme të lartë. Kalimi nga shkolla fillore në shkollën e mesme duhet të përgatitet me kujdes në mënyrë që nxënësi me NVA/aftësi të kufizuara të ketë një mundësi të mirë për të pasur sukses që në fillim të shkollimit.

Dokumentet që përshkruajnë gjendjen shëndetësore të nxënësit dhe nevojat e veçanta arsimore, planet e mëparshme individuale arsimore, arritjet dhe përvojat e mëparshme, mbështetja e nevojshme dhe e ofruar në nivelet më të ulëta të arsimit do të ndihmojnë shkollën e mesme të lartë të bëjë përgatitjet e nevojshme për organizimin e mbështetjes.

Informacioni mund të sigurohet nga nxënësi, prindërit dhe – me lejen e prindërve – ish-mësimdhënësit nga shkolla e mesme e ulët, DKA, autoritetet e mirëqenies sociale dhe shëndetësore, këshilltarë të orientimit në karrierë etj.

Identifikimi gjatë vijimit të shkollës së mesme të lartë

Në rast se nevojat e veçanta arsimore të nxënësit nuk janë identifikuar më herët ose këto shfaqen gjatë vijimit në shkollën e mesme të lartë, mësimdhënësit kanë rol vendimtar në identifikimin e NVA. Mësimdhënësit janë ata që njohin se si manifestohen vështirësitë në të nxënë.

Mësimdhënësi vëzhgon dhe vlerëson të nxënësit, arritjet dhe sjelljen e nxënësve, dhe identifikon se kur një nxënës nuk po bën përparimin e pritur.

Përparimi i nxënësit:

- mund të jetë shumë më i ngadalshëm se ai i nxënësve të tjerë, ose
- nuk përputhet ose përmirësohet me shkallën e përparimit të mëparshëm të nxënësit, ose
- zgjerohet hendeku në mësim mes nxënësit dhe nxënësve të tjerë në klasë.

Nëse, pavarësisht nga mësimdhënia e mirë, përparimi i nxënësit vazhdon të mos përmirësohet, mësimdhënësi duhet të

- ketë diskutim me nxënësin në lidhje me përparimin dhe t'i mundësohet nxënësit të përshkruajë arsyet e sfidave në të nxënë.
- diskutojë me mësimdhënësit të tjerë nëse ata ndajnë të njëjtat mendime me ju.
- diskutoj me prindërit nëse nxënësi është nën 18 vjeç
- diskutojë me mësimdhënësin mbështetës të shkollës/komunës dhe/ose psikologun e shkollës.
- sjellë rastin në ekipin mbështetës.

Vlerësimi nga ekipi komunal i vlerësimit

Identifikimi i NVA-ve nuk mund të bëhet gjithmonë me sukses brenda stafit të shkollës. Në këto raste, shkolla duhet të kontaktojë drejtorinë komunale të arsimit për vlerësim ose rivlerësim të nxënësit me NVA dhe AK.

Në rast se një nxënës i referohet vlerësimit të ekipit komunal të vlerësimit, shkolla është e detyruar të plotësojë një formular të vlerësimit gjithëpërfshirës për nxënësin. Formulari përmban 21 tregues të bazuar në parimin e Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit (KNF). Ekipi komunal i vlerësimit e vlerëson nxënësin bazuar në këta tregues dhe, kur është e nevojshme, i jep rekomandime shkollës për mbështetjen e nevojshme dhe për formulimin e PIA-s për nxënësin.

Drejtoria komunale e arsimit dhe shkollat kontaktojnë sipas nevojave QB. Mësimdhënësit udhëtues nga QB-të mund të vizitojnë shkollën, të diskutojnë me mësimdhënësin dhe anëtarët e ekipit mbështetës, të takojnë nxënësin në mënyrë që të identifikojnë arsyet pas vështirësive në mësim ose sjellje.

Identifikimi i nevojës për mbështetje

Vështirësitë në të nxënë të shkaktuara nga NVA dhe aftësia e kufizuar shfaqen gjithmonë individualisht, dhe është e rëndësishme të zbuloni dhe identifikoni arsyet që qëndrojnë pas tyre në mënyrë që të bëni plane për mbështetje. Informacioni i fituar gjatë procesit të identifikimit do të përdoret për planifikimin dhe ofrimin e mbështetjes.

Pikat e forta dhe sfidat në mësim identifikohen dhe në rastet kur nevojitet mbështetje e veçantë arsimore për nxënësin, duhet të përgatitet PIA. Përmbajtja e PIA-s përshkruhet në kapitullin 5.3.7.

Planifikimi i tranzicionit

Tranzicioni në arsim nënkupton kalimin nga njëra fazë në tjetrën, p.sh. nga arsimi i mesëm i ulët në atë të mesëm të lartë dhe nga arsimi i mesëm i lartë në universitet ose në jetën e punës. Tranzicionet e suksesshme për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara duhet të planifikohen mirë dhe të regjistrohen në PIA të nxënësit dhe në formular të tranzicionit. Kjo do të ndihmojë nxënësin të përparojë gjatë mësimave dhe më vonë t'i bashkohet fuqisë punëtore.

6.3. Përshtatjet dhe modifikimet bazuar në nevojat individuale të një nxënësi

Për shumë nxënës me NVA dhe aftësi të kufizuara çelësi i suksesit në mësim qëndron në sigurimin e përshtatjeve dhe modifikimeve të duhura në programin e tyre arsimor. Siç është përcaktuar më herët:

- Përshtatja është një material, pajisje ose proces mbështetës që do t'i mundësojë një nxënësi të kryej detyrat në mënyrë më efektive; dhe
- Modifikimi u referohet ndryshimeve në përmbajtjen ose rezultatin përfundimtar të modulit.

Përshtatjet dhe modifikimet duhet të individualizohen për një nxënës, bazuar në pikat e forta dhe nevojat e nxënësit, dhe stilet dhe interesat personale të nxënësit.

Përshtatjet

- janë pjesë e praktikave të mira të nxënësit dhe ato mund të bëhen për çdo nxënës.
- bëjnë mësimin të qasshëm dhe i mundësojnë nxënësit të demonstrojnë atë që di pa u penguar nga NVA dhe aftësia e kufizuar e tyre.
- janë ndryshime që ndihmojnë një nxënës të kapërcejë ose të përballë me NVA dhe aftësinë e kufizuar.
- nuk ndryshojnë rezultatet përfundimtare të pritura të të nxënësit, por nxënësve u kërkohet të kryejnë të njëjtat detyra ose teste si nxënësit e tjerë.

//

Shembull: I mundësojnë një nxënësi që ka vështirësi në shkrim të japë përgjigjet e testit të shprehur verbal. Nxënësi ende pritet të dijë të njëjtën përmbajtje të lëndës sikurse nxënësit e tjerë.

//

Përshtatjet mund të përfshijnë si më poshtë:

- Kohë shtesë për të përfunduar detyrën ose testin;
- Arranzhimin fizik të klasës;
- Ulëset preferenciale (p.sh. minimizimi i shpërqendrimeve dëgjimore dhe/ose vizuele)
- Ndryshimin e qasjeve të mësimdhënies (p.sh. vizuele, dëgjimore, shumë-shqisore, demonstrime, modelim, udhëzime individuale/në grupe të vogla);
- Mënyrën e komunikimit p.sh. gjuha e shenjave për personat me dëmtime në dëgjim dhe Braille për personat me dëmtime në shikim;
- Mundësimin e mënyrave të ndryshme të përgjigjes (p.sh. verbalisht, me shkrim, përdorimi i kompjuterit dhe/ose pajisjes ndihmëse);
- Materialet mësimore të përshtatura si materiale me ngjyra të theksuara, print me shkronja të zmadhuara, Braille;
- Përdorimin e pajisjeve ndihmëse p.sh. kompjuteri, llogaritësi;
- Format e ndryshme të dhënies së udhëzimeve (p.sh. skicat e materialeve, udhëzuesit e mësimi, mësimet pas shkollës, udhëzimet në hapa të vegjël vijues);
- Ndryshimin e mënyrës së paraqitjes së materialit udhëzues;
- Ndryshimin e mënyrës së përgjigjeve të nxënësve.

Përshtatjet si të vetme nuk japin gjithmonë mbështetje të mjaftueshme në mësim. Në këto raste, përmbajtja e kurrikulës duhet të modifikohet sipas nevojave dhe aftësive individuale të nxënësit.

Modifikimi i kurrikulës është procesi i modifikimit të kurrikulës sipas niveleve të ndryshme të aftësive të nxënësit. Qëllimi është që të harmonizohen kërkesat njohëse, emocionale, komunikuese dhe fizike të kurrikulës me kapacitetet, pikat e forta dhe nevojat e një nxënësi individual.

Modifikimet e kurrikulës

- bëhen ndryshime në atë që mësohet ose pritët nga nxënësi;
- ndryshojnë pritjet e njohurive për përmbajtjen dhe praktikën e vlerësimit;
- tregohen në PIA të nxënësit.

Modifikimet e kurrikulës mund të jenë të nevojshme për të gjitha ose vetëm për disa pjesë të kurrikulës.

Mësimdhënësit kanë rol të rëndësishëm në modifikimin e kurrikulës. Ata janë ekspertë në njohjen e përmbajtjes kryesore të kurrikulës dhe monitorojnë të nxënësit. Prandaj, ata gjithashtu identifikojnë procesin në të cilin ndodhin vështirësitë në të nxënësit e nxënësit.

6.4. Udhëzime për mësimdhënësit për t'i plotësuar nevojat e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara

Ekziston një larmi e madhe midis dhe brenda kategorive të NVA dhe aftësive të kufizuara, dhe personat me aftësi të kufizuara nuk formojnë një grup homogjen. Personat me të njëjtën diagnozë kanë aftësitë, pikat e forta, sfidat dhe nevojat e tyre unike. Aftësia e kufizuar është vetëm një karakteristikë e një personi me aftësi të kufizuara dhe nuk shpjegon atë që një person mund ose nuk mund të bëjë.

Nevojat e veçanta arsimore dhe aftësitë e kufizuara mund të mos jenë gjithmonë të dukshme nga jashtë. Ato janë lehtësisht të dukshme në rastet për shembull kur një person është duke përdorur karrocë ose shkop të bardhë. Ata mund të mbeten të padukshëm në rastet e personave me vështirësi në perceptim, mungesë të vëmendjes, vështirësi në dëgjim ose shikim të dobët dhe madje edhe me aftësi të kufizuar intelektuale. Prandaj, ju mund të keni nxënës me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollën dhe klasën tuaj pa e ditur.

Është shumë e rëndësishme që kur takoni një nxënës me NVA dhe aftësi të kufizuara ju të:

- shihni nxënësin përtej aftësisë së kufizuar.
- mos bëni asnjë supozim për nxënësin bazuar në llojin e aftësisë së kufizuar.
- njiheni mirë me nxënësin për të gjetur se çfarë mund të bëjë ai/ajo, cilat janë mënyrat e tij/saj më të mira të mësuarit dhe çfarë lloj mbështetjeje ose përshtatje ka nevojë.
- përqendroheni në aftësitë dhe potencialet e nxënësve jo në mungesa.

Gjatë takimit me një nxënës me NVA dhe aftësi të kufizuara, mësimdhënësi duhet ta njohë mirë nxënësin.

Është e nevojshme të diskutohet me nxënësin dhe të zbulohet se

- cilat janë interesimet e nxënësit dhe planet e ardhshme,
- cilat janë sfidat e nxënësit në mësim,
- çfarë lloj mbështetjeje ka marrë nxënësi më parë dhe a ka nevojë tani,
- cilat janë pritjet e nxënësit për mësim,
- cilat janë mënyrat e preferuara të nxënësit të nxënësit.

Kur ka nevojë për mbështetje profesionale, mësimdhënësi mund t'i drejtohet ekipit mbështetës ku janë të përfshirë mësimdhënësi mbështetës dhe psikologu i shkollës, asistenti për fëmijë me NVA dhe nëse zgjidhet nuk janë të disponueshme në shkollë, atëherë shërbimet e DKA-së dhe qendrave burimore janë në dispozicion, siç përshkruhet më herët në kapitullin 5.

Megjithatë shumë nxënës me NVA dhe aftësi të kufizuara duhet të kenë përshtatje dhe modifikime të kurrikulës, plani individual arsimor (PIA) ndihmon në përcaktimin e këtyre ndryshimeve, mbështetjes dhe burimeve të përshtatshme për nxënësin.

- PIA duhet të zhvillohet kur një nxënës fillon arsimin e mesëm të lartë ose menjëherë pasi nxënësi të jetë identifikuar me vështirësi në të nxënë.
- Mbështetja nga mësimdhënësit udhëtues do të jetë në dispozicion sipas kërkesës në përgatitjen e PIA-s.

6.5. Këshilla praktike për mësimdhënësit në menaxhimin e një klase gjithëpërfshirëse

Mësimdhënësi luan rol jetësor në krijimin e një klase gjithëpërfshirëse dhe në zbatimin e veçorive të një klase gjithëpërfshirëse. Cilësitë e mira të mësimdhënësit për të menaxhuar një klasë gjithëpërfshirëse janë

- trajtimi i diversitetit dhe qëndrimet pozitive ndaj diversitetit,
- gatishmëria për t'u marrë me dallimet,
- durimi,
- ndjeshmëria dhe shkathtësitë për të rritur marrëdhëniet shoqërore midis nxënësve,
- të kuptuarit se si të zhvillohen ndërveprime dhe marrëdhënie të mira brenda klasës;
- fleksibiliteti dhe planifikimi i mirë, dhe
- shkathtësitë e mira bashkëpunuese.

Përveç këtyre veçorive, është e rëndësishme që mësimdhënësi të:

- ketë njohuri dhe shkathtësi për t'u marrë me nevojat e ndryshme;
- përdorë metoda dhe materiale të ndryshme për mësimdhënie;
- bëjë përshtatje për të përmbushur nevojat e nxënësve;
- përdorë PIA me modifikime në kurrikulën e nxënësve;
- sigurojë kohë për udhëzime individuale;
- bashkëpunojë me personelin mbështetës dhe mësimdhënësit dhe prindërit e tjerë.

Kapitujt në vijim ofrojnë këshilla të përgjithshme për mësimdhënësit në menaxhimin e klasës gjithëpërfshirëse.

Klimë pozitive në klasë dhe vetëvlerësim pozitiv

Është shumë e rëndësishme për vetëvlerësimin e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara që të ketë një klimë në shkollë dhe në klasë ku diversiteti pranohet dhe vlerësohet. Mësimdhënësit kanë rolin kryesor në krijimin e një klime kaq pozitive në klasë. Kur nxënësit kanë një ndjenjë se të gjithë respektohen, ata mësojnë të respektojnë njëri-tjetrin. Nxënësit duhet të kenë një ndjenjë se ata vlerësohen edhe nëse mund të dështojnë në një detyrë të caktuar. Në një atmosferë që toleron dhe respekton diversitetin, të nxënësve bëhet më i lehtë.

Mësimdhënësit duhet të kenë ndjeshmëri dhe shkathtësi për të rritur marrëdhëniet shoqërore të rëndësishme mes nxënësve. Veçanërisht për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara, ndërveprimet kuptimplota me bashkëmoshatarët e tyre pa aftësi të kufizuara janë të një rëndësie të madhe. Mësimdhënësi duhet të ketë qëndrimin e duhur, por gjithashtu ka nevojë për të kuptuarit e mirë se si të zhvillohen këto ndërveprime dhe marrëdhënie.

Nxënësit me NVA shpesh kanë përjetuar vështirësi në mësim dhe për këtë arsye, ata mund të kenë ndjenjën se nuk janë të aftë të mësojnë. Është e rëndësishme që mësimitdhënësit të kenë pritshmëri të larta por realiste për performancat e të gjithë nxënësve.

Duke i dhënë mundësi një nxënësi të ketë përvoja suksesi, e ndihmoni nxënësin të zhvillojë vetëvlerësim pozitiv. Kjo është shumë e rëndësishme për nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara, pasi shumë prej tyre mund të kenë përvoja të të qenit ndryshe nga të tjerët në një mënyrë të veçantë, duke mos mësuar aq shpejt sa moshatarët e tyre dhe mund të ndihen sikur nuk janë aq të mirë sa të tjerët. Një mësimitdhënësi mund të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë vetëvlerësimin e tyre duke u dhënë mundësi të gjithëve që të kenë përvoja suksesi. Informatat kthyesë pozitive janë të nevojshme për nxënësit kur ata kanë sukses edhe nëse përparimi është i vogël.

Krijimi i një mjedisi optimal të mësimitdhënies

Mësimitdhënësi duhet të jetë i vetëdijshëm se si të organizojë klasën dhe mësimitdhënien në mënyrë që të angazhojë dhe motivojë të gjithë nxënësit dhe të lehtësojë mësimitdhënien në klasë. Nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara mund të kenë nevojë për organizime shtesë për të pasur mjedis optimal të të nxënës, dhe mësimitdhënësi mund të ketë nevojë të:

- sigurojë përdorimin e një këndi mësimi kur është e nevojshme.
- vendosë nxënësin në një zonë të lirë nga shpërqendrimet.
- eliminojë të gjitha materialet e panevojshme nga banka e nxënësit për të zvogëluar shpërqendrimet.
- përdorë listë kontrolli për të ndihmuar nxënësit të organizohen.
- mbajë furnizim shtesë me lapsa, stilolapsa, libra dhe letra në klasë.
- iu mundësojë nxënësve pushime të shpeshta.
- ketë shenjë sugjerimi të rënë dakord më parë që nxënësi të largohet nga klasa.
- zvogëlojë shpërqendrimet vizuale në klasë.
- i mundësojë nxënësit të përdorë ndihma shtesë kur është e nevojshme.

Planifikimi dhe zbatimi i mësimit

- Shpjegojini nxënësit pritshmëritë e mësimit para fillimit të një mësimi.
- Sigurohuni që të keni vëmendjen e nxënësit para fillimit të një mësimi.
- Përfshini aktivitete që pasqyrojnë preferencat dhe përvojat e nxënësit.
- Kufizoni numrin e koncepteve të paraqitura në të njëjtën kohë.
- Ofroni mbështetje shtesë nxënësit.
- Sigurohuni që ka mundësi të mjaftueshme për të praktikuar shkathtësi të reja.
- Sigurohuni që përfshihen aktivitetet e përgjithshmit dhe mirëmbajtjes.
- Modifikoni pritjet bazuar në nevojat e nxënësve.

Detyra optimale

Detyrat duhet të jenë optimale për një nxënësi. Detyrat shumë të vështira ose shumë të lehta mund të çojnë në zhgënjim. Gjatë dhënies së detyrave është mirë të mbani mend që të:

- ndani detyrat në segmente më të shkurtra.
- jepni detyra alternative, jo të gjata me shkrim.
- rregulloni detyrat në gjatësi, përmbajtje dhe kohë.
- jepni udhëzime vizuale me shkrim dhe me gojë nëse është e mundur.
- nënvizoni ato për të tërhequr vëmendjen e nxënësit në pikat kryesore brenda udhëzimit me shkrim të detyrës.
- kontrolloni nëse të gjitha detyrat e shtëpisë janë shkruar saktë në një lloj agjende/libri të detyrave të shtëpisë. Nënshkruani atë, dhe sigurohuni që edhe prindërit ta nënshkruajnë atë.
- siguroni skica, udhëzues studimi, kopje të shënimeve të përgjithshme.
- ofroni stimul për fillimin dhe përfundimin e materialit.

Përgjigjet e pritshme për nxënësit, menaxhimi i kohës dhe tranzicionet

Shumica e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara kërkojnë më shumë kohë për të kryer detyrat sesa të tjerët. Gjatë planifikimit të mësimit, është mirë të mbani mend që të:

- mundësoni më shumë kohë për të bashkëvepruar dhe për t'iu përgjigjur materialeve dhe aktiviteteve mësimore.
- jepni kohë shtesë për të përfunduar detyrën.
- ofroni mundësi që nxënësi të shprehë atë që di në mënyra të shumta (p.sh. përmes tekstit, fjalës, lëvizjes, ilustrimit).
- krijoni hapësirë pune në periudha të shkurtra me pushime.
- mundësoni kohë shtesë për përfundimin e detyrave të shtëpisë.
- informoni nxënësin me disa rikujtime, disa minuta larg, para se të ndryshoni nga një aktivitet në tjetrin.
- zvogëloni sasinë e punës nga detyra e rregullt.

Përsëritja

Nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara mund të përfitojnë më shumë nëse informacioni i ri përsëritet sepse ata zakonisht janë më të ngadaltë në përpunimin e informacionit sesa të tjerët.

Ofrimi i kohës shtesë për detyra

Shumica e nxënësve me NVA dhe aftësi të kufizuara kërkojnë më shumë kohë për të kryer detyrat sesa të tjerët.

Mbështetje në klasë

Nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara kanë nevojë për kohë shtesë për mbështetje. Mësimdhënësi mund të ofrojë mbështetje shtesë përmes:

- organizimit të aktiviteteve të një mësimi për t'i dhënë më shumë kohë mësimdhënies individual (p.sh. punë në grup, punë individuale).
- parashikimit, mësimit paraprak dhe përsëritjes së detyrave që janë sfiduese për nxënësin.

Për më tepër, mbështetja mund të ofrohet nga një asistent për nxënësit me NVA dhe mësimdhënësi mbështetës.

Menaxhimi i sjelljes në klasë

Në vijim mund të ndihmojnë mësimdhënësit në kontrollin e sjelljes në klasë:

- Përcaktoni rregullat e klasës; rregulli kryesor është respektimi i njëri-tjetrit.
- Shmangni konfrontimet dhe luftën për dominim.
- Siguroni një model të përshtatshëm bashkëmoshatarësh.
- Zhvilloni një sistem ose kod që do ta dinë nxënësit se kur sjellja nuk është e përshtatshme.
- Injoroni sjelljet e kërkimit të vëmendjes që janë përçarëse për klasën.
- Zhvilloni një kod të sjelljes për klasën dhe shfaqeni atë vizualisht në një vend të përshtatshëm ku të gjithë nxënësit mund ta shohin shpesh.
- Zhvilloni një plan ndërhyrjeje në sjellje që është real dhe i zbatueshëm lehtë.
- Ofroni përforcim dhe informata kthyesë të menjëhershme.
- Bëjeni kurrikulën më kreative me materiale që kanë kuptim për nxënësit: i ndihmon nxënësit të interesohen dhe të përfshihen.
- Zhvilloni shkathtësi vëzhgimi dhe regjistrimi për të përcaktuar se çfarë shkakton problem të veçantë të sjelljes.

6.6. Si të mbështeten nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta të rregullta

Nën-kapitujt e mëposhtëm japin informacione bazike rreth nevojave të ndryshme të veçanta arsimore dhe aftësive të kufizuara dhe çfarë sfidash në mësimnxënie mund të shkaktojnë ato. Për më tepër, janë dhënë këshilla për mësimdhënësin se si të mbështeten nxënësit me NVA dhe aftësi të kufizuara në klasë në shkollat e mesme të larta të rregullta.

Duhet të theksohet se nevojat e veçanta arsimore manifestohen individualisht. Edhe në rast të diagnozës së njëjtë, nevojat dhe shkathtësitë e tyre janë unike. Andaj, mësimdhënësi duhet t'ia njohë mirë nxënësin.

6.6.1. Nxënësit me aftësi të kufizuara specifike në të nxënë

Përkufizimi

Një vështirësi specifike në të nxënë është një mënyrë e ndryshme e të nxënëit, organizimit dhe përpunimit të informacionit dhe ndodh në:

- lexim, shkrim dhe/ose matematikë.
- mund të shfaqen edhe vështirësi në perceptim, mungesë i në vëmendje dhe mungesë në shkathtësitë motorike të nxënëit.

Performanca akademike e nxënësit nuk është në përputhje me aftësinë e tij ose të saj për të mësuar, ose me moshën ose talentin.

Vështirësia specifike në të nxënë nuk shkaktohet nga ndonjë dëmtim ose nuk rezulton nga mësimdhënia e pamjaftueshme.

Vështirësitë në mësim mund të përfshijnë

Disleksia

- Vështirësi në leximin dhe njohjen e saktë të fjalëve
- Vështirësi në të kuptuarit e leximit dhe fjalor i kufizuar
- Vështirësi të përgjithshme në të nxënë gjatë leximit

Disgrafia

- Vështirësi gjatë shprehjes me shkrim dhe formimit të shkronjave dhe numrave me dorë
- Vështirësi në drejtshkrim, dorëshkrim dhe shprehje të mendimeve në letër
- Vështirësi në detyra që kërkojnë të menduarit dhe të shkruarit në të njëjtën kohë, siç është marrja e shënimeve

Diskalkulia

- Vështirësi gjatë përpunimit të numrave dhe sasive dhe gjatë mësimit të koncepteve të lidhura me numra.
- Vështirësi në kryerjen e shkathtësive matematikore bazë dhe llogaritje të sakta matematikore, dhe arsyetimin dhe zgjidhjen e problemeve.
- Problem në rikujtimin e fakteve themelore matematikore (si tabelat e shumëzimit) dhe vështirësi në kuptimin e parave dhe vlerësimin e sasive
- Orientim i dobët vizual dhe hapësinor
- Vështirësi në zgjidhjen e shpejtë të drejtimit (djathtas-majta)
- Probleme me njohjen e modeleve dhe renditjen e numrave

Si të përmbushen nevojat në klasën e rregullt

Çdo vështirësi në të nxënë duhet të vlerësohet individualisht dhe ndihma mund të jepet në forma të tilla si:

- Ofrimi i udhëzimeve të mësimave, testeve praktike, teksteve shkollore për të nënvizuar dhe librave të incizuar.
- Mundësimi i formave alternative të përgjigjes, kohës shtesë ose vendeve alternative për të bërë punë ose për t'u testuar.
- Aplikimi i metodave të shumëfishta të ofrimit.
- Ofrimi i udhëzimeve verbale për ata që kanë nevojë për to.
- Ofrimi i shënimeve paraprakisht.
- Mundësimi i më shumë kohë në detyra dhe teste.
- Mundësimi i përdorimit të një llogaritësi ose kompjuteri.
- Përshtatja e vështirësisë së detyrës.
- Ndarja e problemeve të ndërlikuara të matematikës në hapa më të vegjël
- Përdorimi i posterave për t'ia kujtuar nxënësit konceptet themelore të matematikës.
- Ofrimi i informacionit shtesë përmes mësimave interaktive të bazuara në kompjuter ose projekte praktike.

Kufizimet/profilet e preferuara në arsimin e mesëm të lartë

Kufizimet, nëse ka, janë individuale. Me mbështetjen, mësimdhënien dhe praktikën e duhur, nxënësit me vështirësi specifike në të nxënë do të gjejnë mënyra të ndryshme për të mësuar dhe përdorur ato strategji me sukses gjatë gjithë jetës së tyre.

6.6.2. Nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale

Përkufizimi

Aftësia e kufizuar intelektuale është një aftësi e kufizuar e karakterizuar nga kufizime të rëndësishme si në funksionimin intelektual ashtu edhe në sjelljen adaptive. Funksionimi intelektual i referohet kapacitetit të përgjithshëm mendor, siç janë të nxënit, arsyetimi, zgjidhja e problemeve dhe funksionet e kujtesës. Sjellja adaptive është një varg i shkathtësive konceptuale, shoqërore dhe praktike që nevojiten në jetën e përditshme.

- Shkathtësitë konceptuale: gjuha dhe shkrim-lëximi; konceptet për para, kohë dhe numër; dhe vetë-drejtimi.
- Shkathtësitë sociale: shkathtësitë ndërpersonale, përgjegjësia shoqërore, vetëvlerësimi, mendjelehtësia, zgjidhja e problemeve sociale, aftësia për të ndjekur rregullat/respektimi i ligjeve dhe për të shmangur viktimizimin.
- Shkathtësitë praktike: aktivitetet e jetës së përditshme, shkathtësitë profesionale, kujdesi për veten dhe shëndetin, siguria, përdorimi i parave dhe telefonit, udhëtimi/transporti, etj.

Vini re se:

- Aftësitë e kufizuara intelektuale janë të një larmie të madhe dhe intensiteti dhe shkalla e aftësisë së kufizuar ndryshojnë shumë.
- Nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale nuk formojnë asnjë grup homogjen dhe secili prej tyre ka pikat e forta dhe nevojat e veta individuale.
- E vetmja gjë e përbashkët është vështirësia në të kuptuarit dhe të mësuarit dhe kjo ndryshon nga e lehtë në të konsiderueshme.

Vështirësitë në mësim:

- Vështirësi në zhvillimin e shkathtësive shoqërore dhe komunikuese
- Rritja e kohës së nevojshme për përpunimin njohës të detyrave ose materialeve të reja mësimore
- Vështirësi në të kuptuarit e informacionit të ri ose të ndryshëm
- Vështirësi në të kuptuarit ose kuptimin e koncepteve abstrakte
- Vështirësi në përpunimin e informacionit në mënyrë logjike.

Si të përmbushen nevojat në klasën e rregullt dhe mbështetja e nevojshme

Nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale kanë nevojë për shërbime dhe ndihma shtesë.

1. Mjedisi fizik

- Ofrimi i një mjedisi të strukturuar dhe strategji të specializuara mësimore që mbështesin dhe rrisin potencialin mësimor të nxënësit.

2. Përgatitja

- Udhëzimet dhe materialet mësimore të përshtatura për aftësitë mësimore të secilit individ
- Vendosni nxënësit me aftësi të ndryshme të punojnë drejt një qëllimi të përbashkët (psh. Projekt)
- Jepini nxënësit shënime të mësimdhënësit ose ligjëratat të incizuara.

3. Stili i modifikuar i mësimdhënies

- Përdorni gjuhë dhe fjalë të thjeshta dhe ilustroni me fotografi ose paraqitje të tjera vizuale.
- Modifikoni mësimdhënien që të jetë më praktike dhe të jetë sa më konkrete që të jetë e mundur.
- Përdorni qasje shumë-shqisore.
- Ndani mësimin në pjesë më të vogla, dhe detyrën në hapa të vegjël më të lehtë për t'u menaxhuar. Demonstroni hapat. Prisni derisa nxënësi të zotërojë hapin para se të kaloni në hapin tjetër. Përsëriteni çdo hap derisa nxënësi të jetë në gjendje ta bëjë atë në mënyrë korrekte. Pastaj shkoni në hapin tjetër, derisa procesi të përfundojë pasi mund të nevojiten shumë përsëritje.
- Sigurohuni që nxënësi të kuptojë detyrën.

- Jepini nxënësit kohë shtesë për të përfunduar detyrën ose testet.
- Ofroni nxënësit mundësinë të punojë me një tutor në një grup të vogël ose me një bashkëmoshatar.
- Mundësoni nxënësit të përgjigjet verbalisht ose me kompjuter.
- Jepni mbështetje për të përfunduar detyrën.
- Bëhuni të durueshëm.
- Qëndroni inkurajues dhe jepni informata kthyesë të menjëhershme.
- Ndhmoni nxënësin të mësojë shkathtësi për jetë.
- Komunikoni rregullisht me prindërit dhe kujdestarët e nxënësit tuaj.

Kufizimet/Profilet e preferuara në arsimin e mesëm të lartë

Dobësitë në aftësinë e përgjithshme për të mësuar dhe përpunuar informacionin rezultojnë gjithnjë në arritje të ulëta në të gjitha fushat akademike. Profilet e AAP-së të përshtatura për nevojat individuale.

6.6.3. Nxënësit me dëmtime në dëgjim

Përkufizimi

Dëmtimi i dëgjimit ndryshon nga dëmtimi i lehtë deri në shurdhimin total.

- Të shurdhët e lindur dhe ata që humbasin dëgjimin para se të mësojnë të flasin dhe gjuha e shenjave është gjuha e tyre.
- Nxënësit e shurdhër përdorin gjuhën e shenjave për të komunikuar dhe në klasë ata duhet të ndihmohen nga interpretët e gjuhës së shenjave.
- Të shurdhëruarit janë ata që kanë humbur dëgjimin pasi kanë mësuar të flasin. Ata mund të jenë në gjendje të shprehen me të folur, por kanë nevojë për mënyra të tjera komunikimi si gjuha e shenjave, fjalimi me gjepte, drejtshkrimi i gishtërinjve, leximi i buzëve dhe shkrimi për të kuptuar të tjerët.
- Personat me vështirësi në dëgjim kanë dëgjim të mbetur të mjaftueshëm për të mundësuar përpunimin e suksesshëm të informacionit gjuhësor përmes dëgjimit. Sistemet e dëgjimit FM, aparatet e dëgjimit dhe leximi i buzëve mund të ndihmojnë nxënësit me vështirësi në dëgjim.

Vështirësitë në mësim:

- Mësimdhënie e dobët dhe mungesë e mësimdhënësve që flasin rrjedhshëm gjuhën e shenjave ose interpretët e gjuhës së shenjave.
- Vështirësi në mësimin e të folurit dhe përvetësimin e gjuhës së shkruar dhe të folur
- Zhvillimi i dobët i fjalorit dhe gramatikës
- Vështirësi në të kuptuarit e teksteve të shkruara dhe të shprehurit me shkrim.
- Mjedisi fizik i klasës: klasa të zhurmshme dhe të ndriçuara dobët

Si të përmbushen nevojat në klasën e rregullt

1. Mjedisi fizik:

- Ulni një nxënës përballë klasës.
- Sigurohuni që nxënësi të shohë fytyrën dhe gjestet tuaja dhe të nxënësve tjerë në klasë gjatë mëimit.
- Shmangni mësimdhënien para dritareve të ndritshme pasi ato kanë tendencë të jenë një shpërqendrim për komunikimin vizual.

2. Përgatitja

- Përdorimi i plotë i mjeteve vizuale (telefonat me tekst, sistemet e sinjalizimit si zilja e zërit ose prekja, orët, alarmet e tymit) dhe instrumenteve të amplifikimit (aparatet e dëgjimit, pajisjet e amplifikimit të klasës siç janë veshët fonikë) është shumë i rëndësishëm.
- Shkruani informacione të rëndësishme në tabelë ose në shënime të dhëna për nxënësit.
- Ofroni udhëzime për marrjen e shënimeve ose bashkëmoshatarë që ndihmojnë në marrjen e shënimeve.
- Interpretët e gjuhës së shenjave për të mbështetur nxënësit e shurdhër.
- Përshtatni kurrikulën për nxënësit me dëmtime të dëgjimit ose të shurdhër.
- Përdorni libra shkollore dhe fletë pune me nivele më të ulëta leximi.

3. Stili i mësimdhënies vizuale

- Përdorni udhëzime të shkruara ose ilustruese dhe përdorni modele të të folurit që janë të qarta dhe të natyrshme, jo të ekzagjeruara dhe sigurohuni që një nxënës që përdor leximin e buzëve mund t'ju shohë
- Jini të durueshëm nëse duhet të prisni përgjigjen.
- Përdorni video me titra.
- Siguroni një larmi përvojash shumë-shqisore për nxënësit. Mundësoni nxënësve të përfitojnë nga modalitetet e tjera të nxënës.
- Përdorni objekte konkrete të tilla si modele, diagrame dhe mostra
- Në provime dhe detyra:
 - Shmangni gjuhën e ndërlikuar dhe fjalitë e gjata në pyetjet e provimit pasi interpretetë mund t'u kërkojë të interpretojnë një test.
 - Mundësoni kohë shtesë nxënësit për të përfunduar provimin kur është e nevojshme.
 - Plotësoni shpjegimet gojore ose shenjat me material të shkruar.

Kufizimet/Profilet e preferuara në arsimin e mesëm të lartë

Kufizimet në lidhje me dëgjimin. Me ndihmat e duhura dëgjimore dhe interpretimin e gjuhës së shenjave, si dhe një mjedis të përshtatshëm të nxënës – nxënësit gjysmë të shurdhër dhe të shurdhër mund të jenë po aq efektivë dhe të aftë në mësim sa bashkëmoshatarët e tyre që dëgjojnë.

6.6.4. Nxënësit me dëmtime në shikim dhe të verbër

Përkufizimi

Dëmtimet vizuale ndahen në dy kategori:

- Shikim të dobët: qartësia e shikimit zvogëlohet përgjithmonë në një nivel të tillë që një nxënës nuk është në gjendje të kryejë detyrat e përditshme vizuale.
- Verbëria: shikimi humbet plotësisht dhe përgjithmonë.

Vështirësitë në mësim:

- Pjesa më e madhe e detyrave shkollore bazohet në një farë mënyre në shikim dhe për këtë arsye, dëmtimi i shikimit ka shumë efekte në të nxënë.

Si të përmbushen nevojat në klasën e rregullt

1. Mjedi fizik:

- Uleni nxënësin pranë zonave kryesore mësimore me shumë burime drite natyrore dhe artificiale.
- Kufizoni zhurmën e jashtme dhe të brendshme duke mbyllur dyert dhe dritaret.

2. Përgatitja

- Përgatitni me kohë dhe bëni të gatshme materialet mësimore (mundësisht në formë elektronike), kështu që ka kohë të mjaftueshme që ato të riprodhohen në audio ose Braille.
- Siguroni paraprakisht materiale të shtypura me shkronja të zmadhuara
- Siguroni materiale me shkëlqim të ulët dhe kontrast të lartë për nxënësin me shikim të dobët.
- Siguroni incizime të ligjëratave dhe çdo material të shtypur në Braille për nxënësit e verbër.
- Përgatitni aktivitete të përshtatshme që zhvillohen jashtë shkollës dhe bëni partnerë nxënësit me nxënës të tjerë që mund të ndihmojnë.
- Kur shfaqni filma dhe video në klasë, jepini nxënësit një njoftim paraprak i cili u mundëson atyre opsione që ta shohin atë paraprakisht shumë pranë ekranit ose të kenë dikë që të shpjegojë filmin ose videon.

3. Stili i mësimdhënies verbale

- Jepni udhëzime të qarta gojore dhe shpjegoni me gojë atë që shfaqet në prezantimet vizuale, lexoni çdo informacion të shtypur dhe përshkruani çdo diagram ose grafik që përdoret.
- Shpërndani fizik i nxënësit të verbër.

- Jini të vetëdijshëm për çdo terminologji që mund të përdorni që do të kërkonte mprehtësi vizuale për të cilën nxënësi nuk është i aftë (p.sh. frazat si "atje" dhe "si ai" do të ishin të papërshtatshme.)
- Në provime dhe detyra:
 - Nxënësi mund të përdorë Braille ose kompjuter;
 - Mund të organizohet koha e zgjatur dhe pushimet gjatë testeve dhe vlerësimeve tjera;
 - Provimet mund të lexohen me zë të lartë.

Kufizimet/Profillet e preferuara në arsimin e mesëm të lartë

Kufizimet që lidhen me shikimin: Përderisa profile të caktuara të arsimit dhe aftësisë profesionale me bazë vizuale nuk janë të përshtatshme për nxënësit me dëmtim në shikim dhe të verbër, me mjete të përshtatshme ndihmëse dhe mbështetje individuale nxënësit e verbër dhe nxënësit me shikim të dobët mund të jenë po aq të suksesshëm në mësimet e tyre sa edhe bashkëmoshatarët e tyre që shohin.

6.6.5. Nxënësit me dëmtime fizike

Përkufizimi

Një dëmtim fizik do të thotë të mos jesh në gjendje të përdorësh duart ose këmbët siç duhet, të qëndrosh, të ulësh ose të lëvizësh. Ka shumë lloje dhe shkallë të ndryshme të dëmtimit fizik siç janë:

- dëmtime të lidhura me lëvizshmërinë,
- dëmtimet shëndetësore dhe mjekësore, dhe
- dëmtime që rezultojnë nga lëndimet e trurit.

Vini re se

- Ndonjëherë aftësitë e kufizuara fizike janë të dukshme; megjithatë jo gjithmonë.
- Disa aftësi të kufizuara fizike kërkojnë përdorimin e një pajisjeje ndihmëse (për shembull, një karrocë ose pajisje për ecje).
- Disa persona me dëmtime fizike mund të shoqërohen nga një person mbështetës personal.

Dëmtimi më i zakonshëm fizik është Paraliza Cerebrale (PC) e cila shkaktohet nga një dëmtim i trurit. PC ka disa forma të cilat mund të përfshijnë lëvizje të detyruara të cilat shpesh kanë ndikim edhe në të folur.

Duhet të theksohet se nxënësit me dëmtime fizike nuk ndryshojnë në aspektin intelektual nga nxënësit tjerë në klasën tuaj.

Vështirësitë në mësim:

- Vështirësitë e qasjes në klasë
- Disa nxënës mund të lodhen shpejtë, si rezultat i përpjekjeve shtesë fizike të nevojshme për të kryer detyrat,
- Disa nxënës mund të marrin ilaçe të forta që ndikojnë negativisht në përqendrimin dhe performancën e tyre
- Për shkak të vështirësisë në kontrollin e lëvizjeve, shkrimi i dorës mund të jetë i vështirë dhe mund të nevojitet kohë e shtuar.

Ekzistojnë shumë pajisje ndihmëse që mund të përdoren për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike që u mundësojnë atyre të marrin pjesë në aktivitete në klasë. Por, aktivitetet duhet të përzgjidhen dhe përshtaten bazuar në nevojat dhe mundësitë e atyre fëmijëve.

Si të përmbushen nevojat në klasën e rregullt

1. Mjedisi fizik

Aktivitetet fizike në klasë duhet të përshtaten me nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike.

- Duhet të përdoren karroca dhe pajisje të tjera;
- Merrni mendimin e nxënësit se si të bëhet ambienti në klasë më i qasshëm për ta;

- Organizoni uljen e nxënësit në mënyrë që ta përfshini plotësisht në diskutimet dhe aktivitetet në klasë dhe mbani hapësirat midis tavolinave dhe siguroni hapësirë të mjaftueshme për lëvizje të nxënësve me aftësi të kufizuara fizike.
- Vendosni pjerrina në çdo derë të çdo salle dhe parrakë në korridore dhe tualete. Dyert duhet të jenë mjaftë të gjera për nxënësit me karroce që të hyjnë në shkollë dhe klasë.

2. Përgatitja

Përshtatjet duhet të bëhen në atë mënyrë që u mundëson nxënësve të marrin pjesë plotësisht në aktivitetet mësimore të organizuara në klasë.

- Sigurohuni që të ketë qasje të lirë në objektin e shkollës dhe oborrin e shkollës, dhe qasje adekuate në të gjitha pjesët e klasës në mënyrë që nxënësi të mund të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet
- Bëni të qasshme materialet e klasës dhe këndet e punës.
- Modifikoni lartësinë, pjerrësinë ose këndin e tavolinës dhe karrigeve për të përmbushur nevojat individuale të nxënësve
- Gjatë hartimit të një aktiviteti, kërkoni metoda alternative të shfaqjes, manipulimit ose prezantimit.
- Ofroni një listë të detyrave me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur

3. Stili i modifikuar i mësimdhënies

- Shkrimi me kompjuter, nëse është e nevojshme;
- Jepni detyra si me gojë ashtu edhe me shkrim për të shmangur konfuzionin
- Inkurajoni nxënësit të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet në masën më të madhe të mundshme.
- Krijoni mundësi që nxënës të ndryshëm të ndihmojnë në mënyrë rotative nxënësit me aftësi të kufizuara fizike për të lëvizë nëpër klasë. Nxënësit shpesh i gëzojnë kësaj përgjegjësie dhe mundësisë për të ndihmuar sa herë që është e nevojshme.
- Ndihmoni nxënësin të përdorë aftësitë e tij/saj për zgjidhjen e problemeve dhe shkathtësitë e të menduarit në përfundimin e një detyre.
- Nxënësit me dëmtime fizike mund të frustrohen dhe për këtë arsye duhet t'u lejohej ca kohë në mënyrë periodike për të folur me nxënësit dhe për t'i ndihmuar ata me ndjenjat e frustrimeve
- Përdorni materiale për të ndihmuar në fiksimin e materialeve të punës (ngjitës letre, kapëse, kapakë ngjitës).
- Përdorni teknologji dhe pajisje adaptive (një kompjuter i përshtatur për nevojat e nxënësit, teknologji ndihmëse informatike, pajisje lëvizëse, kontroll dore, mbështetje krahu/kyçesh, pajisje për shfletimin e faqeve, tastiera të modifikuara, skanerë, programe të njohjes së zërit).

Kufizimet/Profilat e preferuara në arsimin e mesëm të lartë

Në varësi të llojit dhe nivelit të aftësisë së kufizuar, nxënësit me dëmtime fizike mund të jenë të suksesshëm në profilet arsimore që nuk kërkojnë shumë lëvizje fizike.

6.6.6. Nxënësit me Çrregullim të Mungesës së Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit ÇMVH dhe Çrregullim të Mungesës së Vëmendjes ÇMV

Përkufizimi

Nxënësit me ÇMVH (Çrregullimi i mungesës së vëmendjes dhe hiperaktivitetit) kanë vështirësi me vëmendjen, hiperaktivitetin dhe kontrollin e impulsivitetit. Sjellja impulsive dhe hiperaktive e një nxënësi mund të çojë në çrregullime të sjelljes ndonjëherë. ÇMV është një çrregullim i mungesës së vëmendjes pa shqetësime motorike dhe impulsivitet.

Vështirësitë në mësim mund të përfshijnë

- Vështirësitë në përqendrim, vëmendje dhe ndjekje të udhëzimeve;
- Vështirësi në fillimin dhe përfundimin e detyrave;
- Nivel i ulët tolerance dhe nivel i lartë frustrimi (ÇMVH);
- Lehtësisht i shpërqendrueshëm dhe i hutuar;
- Vështirësi në punën në grupe;
- Vështirësi në planifikimin e veprimeve dhe orareve;

Si të përmbushen nevojat në klasën e rregullt

- Sigurohuni që nxënësi të ketë punë dhe minimizoni shpërqendrimet në klasë.
- Bëni udhëzimet dhe detyrat tuaja të qarta dhe sa më të shkurtra të jetë e mundur.
- Mundësoni pushime të shpeshta ose kohë për të lëvizur.
- Sigurohuni që nxënësi të ketë detyrë që ai/ajo mund ta përfundojë me sukses çdo ditë.
- Jepni kohë shtesë në teste dhe sqaroni pritjet dhe ndihmoni të qëndrojnë të organizuar.
- Vendosni shpesh kontakt me sy me nxënësit dhe përdorni kontaktin fizik p.sh. një dorë në krah për të përqendruar vëmendjen.
- Krijoni dhe përdorni një sinjal të fshehtë për t'i njoftuar nxënësit kur janë jashtë detyrës ose sillen keq.
- Jepni kurajo dhe informata kthyesë pozitive.

Kufizimet/Profilet e preferuara në arsimin e mesëm të lartë

Kufizimet, nëse ka, janë individuale. Sidoqoftë, njerëzit me ÇMVH shpesh janë kreativ, inovativ, energjik dhe nuk kanë frikë të marrin përsipër sfida të reja dhe kjo duhet të inkurajohet aty ku është e mundur.

6.6.7. Nxënësit me Çrregullim të Spektrit të Autizmit

Përkufizimi:

Çrregullimi i spektrit të autizmit (ÇSA) është një gjendje neuro-zhvillimore dhe një aftësi e kufizuar zhvillimore që mund të shkaktojë sfida të konsiderueshme shoqërore, komunikuese dhe të sjelljes. ÇSA përfshin disa kushte, për shembull çrregullimin autik dhe sindromën Asperger. Karakteristikat ndryshojnë në varësi të personit dhe mund të shkojnë nga të lehta në të rënda.

Disa shenja të zakonshme të çrregullimit të spektrit të autizmit përfshijnë:

- Vështirësi në të folur ose në kontakt me sy
- Preferenca për të luajtur vetëm dhe shpesh "në botën e tyre"
- Fiksime të pazakonta me objekte ose aktiviteteve të caktuara
- Vështirësi në ndërveprimet shoqërore me nxënësit e tjerë
- Ndjesi të tepërt ndaj zhurmave ose imazheve
- Mënyrat për të komunikuar, bashkëvepruar, sjellë dhe mësuar janë të ndryshme nga shumica e njerëzve të tjerë

Aftësitë e të mësuarit, të menduarit dhe zgjidhjen e problemeve të njerëzve me ÇSA mund të shkojnë nga të talentuar deri në të sfiduar rëndë. Disa njerëz me ÇSA kanë nevojë për shumë ndihmë në jetën e tyre të përditshme; të tjerët kanë nevojë për më pak, nëse kanë.

Shenjat e ÇSA-së fillojnë gjatë fëmijërisë së hershme dhe zakonisht zgjasin gjatë gjithë jetës së një personi.

Njerëzit me autizëm mund të:

- kenë probleme në lidhje me të tjerët ose nuk kanë interes për njerëzit e tjerë fare
- shmangin kontaktin me sy dhe dëshirojnë të jenë vetëm
- kenë probleme të kuptojnë ndjenjat e njerëzve të tjerë ose të flasin për ndjenjat e tyre
- duken se nuk janë në dijeni kur njerëzit flasin me ta, por u përgjigjen tingujve të tjerë
- jenë shumë të interesuar për njerëzit, por nuk dinë si të flasin, të luajnë ose të lidhen me ta
- përsërisin ose jehojnë fjalë ose fraza që u janë thënë, ose përsërisin fjalë ose fraza në vend të gjuhës normale
- kenë probleme në shprehjen e nevojave të tyre duke përdorur fjalë ose lëvizje tipike
- kenë probleme me përshtatjen kur ndryshon një rutinë,
- kenë reagime të pazakonta ndaj mënyrës se si nuhasin, shijojnë, duken, ndiejnë ose tingëllojnë.

Vështirësitë në mësim:

- sfidat në komunikim mund të shkaktojnë probleme në të nxënë në përgjithësi,
- shpesh shoqërohet me ÇMVH dhe aftësi të kufizuara specifike në të nxënë ,

- të nxëniet e nxënësve nuk ndikohet domosdoshmërisht nga mungesa e aftësisë njohëse,
- vështirësi socio-emocionale dhe/ose sensoromotorike,
- shumë nxënës me autizëm përballen me bullizëm.

Si të përmbushen nevojat në klasën e rregullt

- shmangni mbingarkesën shqisore në dekorimet ose aktivitetet e klasës, të cilat mund ta bëjnë të vështirë për nxënësit me autizëm që t'i kushtojnë vëmendje,
- krijoni rutina të qarta dhe të rregulluara në klasë
- përgatitni një nxënës se kur parashikohen ndryshime
- planifikoni dhe praktikoni strategji komunikimi dhe rutina shoqërore
- lëroni nxënësin të përdorë kufje ose kufje që heqin zhurmën në vende të zhurmshme
- ofroni nxënësit një zonë të qetë ku mund të bëjë një pushim nëse është e nevojshme
- siguroni udhëzime dhe orare vizuale ose të shkruara (nxënës vizual)
- paraqisni përmbajtje të re ose të vështirë të paraqitur në mënyra të ndryshme, por veçanërisht duke treguar se çfarë duhet bërë
- lëroni nxënësin të përdorë kompjuterin, veçanërisht programin për përpunimin e tekstit për të shkruar
- nxënësit me spektër autizmi përfitojnë nga udhëzimet strukturore dhe rutinat e përditshme,
- përdorni gjuhë fjalë për fjalë pasi shumë nxënës me autizëm kanë vështirësi të kuptojnë gjuhën figurative.
- nos supozoni se një nxënës me autizëm është me aftësi të kufizuara intelektuale.

Kufizimet/Profilat e preferuara në arsimin e mesëm të lartë

Kufizimet janë individuale. Shumë nxënës me sindromën Asperger janë shumë të suksesshëm në mësimet e tyre. Nxënësit me autizëm duhet të mësohen individualisht në mësimet e përshtatura për nevojat e tyre individuale.

6.6.8. Nxënësit me probleme emocionale

Definicion:

Nxënësit me probleme emocionale

- Demonstrjnë mungesë të aftësive për të ndërtuar ose mbajtur marrëdhënie të kënaqshme ndërpersonale;
- Zhvillojnë simptoma fizike ose frikë të lidhura me probleme personale ose shkollore,
- Shfaqin disponim të theksuar të pakënaqësisë në rrethana normale, ose
- Shfaqin lloje të papërshtatshme të sjelljes në rrethana normale.

Vështirësitë në mësim

- Nxënësit e sfiduar emocionalisht përfitojnë nga një program shumë i strukturuar – një program në të cilin radhitja e aktiviteteve dhe procedurave është konstante dhe e qëndrueshme.

Si të përmbushen nevojat në klasën e rregullt dhe mbështetja e nevojshme

- Sa herë që është e mundur, jepini nxënësit një ndjenjë përgjegjësie. Vendoseni nxënësin në krye të diçkaje të vogël dhe sigurohuni që ta vlerësoni përpjekjen.
- Ofroni mundësi që nxënësi të zgjedhë vetë një aktivitet;
- Ftojini nxënësin të ndajë gjetjet ose zbulimet e tij/ saj me pjesën tjetër të klasës.
- Përfshini nxënësin në aktivitete me nxënës të tjerë dhe- veçanërisht ata nxënës që mund të shërbejnë si modele të mira për nxënësin.
- Diskutoni sjelljen e përshtatshme të klasës në intervale të shpeshta.
- Sigurohuni që ta ulni nxënësin larg çdo shpërqendrimi
- Sa herë që është e mundur, mbani aktivitetet të shkurtra dhe të shpejta.
- Jepni informata kthyesë të menjëhershme, inkurajim dhe lavdërime të shpeshta.

Kufizimet/Profilat e preferuara në arsimin e mesëm të lartë

- Nxënësit e mësuar dhe mbështetur siç duhet pritet të mos kenë kufizime në arsimin e mesëm të lartë dhe më gjerë.

Referenca

L. Aliu, 2019. Analiza e sistemit arsimor të Kosovës. Fondacioni Friedrich Ebert. <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/15185-20190220.pdf>

Ligji Nr. 04/L-32 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Prishtinë, Kosovë: Gazeta Zyrtare e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës. Prishtinë, Kosovë: Gazeta Zyrtare e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare. Prishtinë, Kosovë: Gazeta Zyrtare e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe aftësimin Profesional. Prishtinë, Kosovë: Gazeta Zyrtare e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Fondacioni i Biznesit për Arsimin. 2018. PROFILI i Qendrës së Karrierës me Bazë Shkollore për Shkollat e AAP-së në Kosovë. Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC. 2018. http://helvetas-ks.org/eye/file/repository/Profile_School_Based_Career_Center_ENG1_3.pdf

Këshilli i Bashkimit Evropian. 2017. Konkluzionet e Këshillit dhe të Përfaqësuesve të Qeverive të Shteteve Anëtare, të mbledhura brenda Këshillit, mbi Gjithëpërfshirjen në Diversitet për të arritur një Arsim të Cilësisë së Lartë për të Gjithë. Bruksel: 17 shkurt 2017. 6356/17

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH, GlZ. Raporti i Vlerësimit për vitin 2019 mbi Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-2021.

Arsimi dhe Sistemi i AAP-së në Kosovë. Aleanca e Ballkanit Perëndimor për Mësim të Bazuar në Punë. 2018. Nisma për Reformën në Arsim e Evropës Juglindore. <https://wba4wbl.com/kosovo/education-and-vet-system/>

Udhëzime për mësimnxënien dhe mësimdhënien gjithëpërfshirëse në shkollat e mesme dhe universitetet VETËM VERSION PUNUES Redaktorët: Bridget Middlemas, Liesbeth Spanjers & Clara Rubiano. 2018. Zhvillimi dhe Zbatimi i Strategjive të Dimensionit Social në Armeni dhe Bosnjë dhe Hercegovinë përmes mësimnxënies ndër-rajonale të bashkëmoshatarëve

<http://inclusionerasmus.org/wp-content/uploads/2017/06/FINAL-DRAFT-INCLUSION-Guidelines-November-2018-SENT-1.pdf>

Gjithëpërfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara në Arsimin dhe Aftësimin Teknik dhe Profesional

- Një udhëzues për Administratorë dhe instruktorë për gjithëpërfshirjen e aftësisë së kufizuar. (2016). Organizata Ndërkombëtare e Punës.

Karjalainen M. & Lindroos S. & Matero M. & Simola T. 2020: Kasvatus- ja ohjausalan käsikirja. (Doracak për Arsim dhe Udhëzim). Porvoo: SanomaPro;

Lappalainen, K., Waltzer, K. & Hotulainen, R. 2020. Nevojat dhe Aftësitë e Kufizuara të Veçanta Arsimore tek të Rinjtë (Finlandë). Botime Bloombury.

Paafësi e të nxënësve. <https://www.ldrfa.org/learning-disability-adhd-facts/>

Malone, K. 2021. Sfidat me të cilat përballen nxënësit me Autizëm. <https://www.graduateprogram.org/2021/01/the-challenges-students-with-autism-face/>

Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Udhëzimi administrativ Nr. 18/2013 për përdorimin e Planit Individual Arsimor - PIA

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Udhëzimi administrativ Nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës

Ministria e Arsimit dhe Shkencës Udhëzimi administrativ Nr. 16/2017 për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Udhëzimi Administrativ Nr. 2/2018 për Qendrat Burimore

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës. (2017, korrik). Plani Strategjik i Arsimit në Republikën e Kosovës 2017-2021. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020.

Mitchell D. 2014. Çfarë funksionon vërtet në arsimin e veçantë dhe gjithëpërfshirës: Përdorimi i strategjive të mësimdhënies së bazuar në dëshmi.

Naser, Z, Perolli Shehu, B. & Anderson, J.A. (2020) Të kuptuarit e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë: Argumentimi ligjor dhe empirik. Revista e Qendrës për Studime të Politikave Arsimore. Qershor 2020. <https://www.bing.com/search?q=TheUnderstandingofInclusiveEducationinKosovo-LegalandEmpericalArgumentation.pdf&cvd=c3879d7a01f04d8aaecf16a61c4f5b59&aqs=edge..69i57.957j0j4&FORM=ANAB01&PC=U531>

Opetushallitus. 2018. Erityinen tuki ammatillisessa koulutuksessa. (Agjencia Kombëtare Finlandeze për Arsimin. 2018. Mbështetje e veçantë në arsimin dhe aftësimin profesional) <https://eperusteet.opintopolku.fi/eperusteet-service/api/dokumentit/4637898>

Portal shtetëror i Kosovës: <https://www.rks-gov.net/EN/f276/education/vocational-education>

Strategjitë për mësimdhënie të nxënësve me aftësi të kufizuara intelektuale. 2018. Therapytravelers. <https://therapytravelers.com/strategies-teaching-students-intellectual-disabilities/>

Studentët me aftësi të kufizuara intelektuale (5 metoda për të ndihmuar). Për klasë. <https://classful.com/students-with-an-intellectual-disability/>

Mësimdhënie për nxënës me nevoja të veçanta <https://www.teachervision.com/special-needs/teaching-students-special-needs>

Njohja e nevojës për mbështetje. <https://oppimateriaalit.jamk.fi/seninet/fundamentals-of-learning-difficulties/recognition-of-the-need-for-support-2/>

